Varfëria e fëmijëve në Shqipëri

Kartë Raportuese, Nr. 1

Qershor 2013

Mbështetur nga unicef

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

"Observatori për të Drejtat e Fëmijëve" u themelua në vitin 2009 me mbështetjen e UNICEF. Gjatë periudhës 2009-2013, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve krijoi rrjetin e tij në të gjitha qarqet e vendit. Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, si strukturë e shoqërisë civile, është i angazhuar në vëzhgimin e të drejtave të fëmijëve në çdo bashki e komunë të Shqipërisë, me qëllim tërheqjen e vëmëndjes të të gjitha institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare si edhe të komuniteteve të qytetarëve mbi domosdoshmërinë e reformimit të politikave të mirëqenies sociale. Observatori ka për qëllim nxitjen e përpjekjeve dhe reformave në nivel qendror dhe lokal, në zbatim të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

Karta raportuese "Varfëria e fëmijëve në Shqipëri" paraqit një vështrim krahasues të mirëqenies së fëmijës në Shqipëri, duke përdorur të dhëna dhe shifra të viteve të fundit (2009-2012). Ky raport kontribuon në zhvillimin e politikave publike kombëtare e rajonale të mirëqenies sociale në interesin më të mirë të fëmijës. Të gjitha statistikat dhe të dhënat në këtë raport janë prodhuar nga institucionet zyrtare kombëtare, rajonale dhe lokale dhe janë përpunuar nga zyra e Observatorit. Raporti merr në konsideratë pesë dimensione themelore të mirëqenies së fëmijëve: mirëqenien materiale, shëndetin dhe sigurinë, arsimin, sjelljet dhe rreziqet si dhe strehimin dhe mjedisin, mbështetur në analizën e 26 treguesve të krahasueshëm.

Aktiviteti dhe publikimet e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve, duke sjellë informacionin e çdo bashkie dhe komune, kontribuojnë në zhvillimin efektiv të debatit kombëtar mbi të drejtat e fëmijëvesi si një çështje e të gjithë shoqërisë shqiptare.

Pikëpamjet dhe konkluzionet e paraqitura në këtë raport përfaqësojnë mendimet e autorëve dhe kontribuesve të tjerë. Kërkesa për leje për të riprodhuar ose përkthyer raportin ose pjesë të tij duhet të adresohet në zyrën e Observatorit në Director@observator.org.al ose Stat@observator.org.al

Për të shkarkuar këtë raport, ose për të hyrë në skedarin e publikimeve më të reja, vizitoni faqen e internetit të Observatorit në www.observator.org.al

Adresa postare:
Observatori Kombëtar, Zyra qendrore,
Bulevardi «Bajram Curri», Pallatet Agimi, Shkalla 5, Ap.81
Tiranë, Shqipëri
Tel. 00355 4 22 58 987
E-mail Director@observator.org.al
Stat@observator.org.al
Web www.observator.org.al

Falënderime

Ky raport është përgatitur nga një grup ekspertesh të Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve në bashkëpunim me specialistë të UNICEF. Elma Tërshana (PhD), Drejtore Ekzekutive e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve, Mina Mata (MA), Administratore Kombëtare e të Dhënave tek Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, të mbështetur nga Drinold Sema, specialist për Informacionin dhe Teknologjinë në UNICEF, Prof.Asoc.Dr. Arlinda Ymeraj, specialiste për Politikat Sociale në UNICEF, hartuan metodologjinë, drejtuan punën përgjatë mbledhjes së të dhënave në terren, analizuan të dhënat dhe përgatitën raportin. Një falenderim shkon për ekspertët lokalë për bashkëpunimin e hapur dhe mbështetjen me të dhëna.

Grupi i punës falenderon Prof. Dr. Ahmet Ceni dhe Vilma Kolpeja për kontributin e tyre të paçmuar në hartimin e metodologjisë të matjes së varfërisë së fëmijëve si edhe në përpunimin e të dhënave nga AMNJ, 2008 për vlerësimin e varfërisë të fëmijëve.

Falenderime të veçanta i shkojnë ekipit të Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve për kontributin në përgatitjen e këtij raporti.

Grupi i specialisteve falenderon UNICEF-in që mundësoi financiarisht studimin dhe veçanërisht Z. Detlef Palm për mbështetjen.

Raporti i studimit u përkthye në gjuhën angleze nga Zana Kondi, u redaktua në shqip nga Ledia Abazi dhe u përpunua dhe redaktua në anglisht nga Dr. Iain F.Wilson.

Përmbledhje ekzekutive

Raporti *"Varfëria e Fëmijëve në Shqipëri"* është përpjekja e parë për të pasqyruar nëpërmjet të dhënave situatën ekonomike dhe sociale të fëmijëve në Shqipëri. Raporti i mbështetur mbi përvojën e mëparshme të vendeve të tjera, është një vlerësim gjithëpërfshirës i jetës dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve në nivel vendi duke u bazuar në të dhënat e 26 treguesve të krahasueshëm. Të dhënat e këtyre treguesve ndihmojnë për të vëzhguar dhe analizuar mirëqënien e fëmijëve sipas pesë dimensioneve, të cilat janë: mirëqenia materiale, shëndeti dhe siguria, arsimi, sjelljet dhe rreziqet dhe strehimi e mjedisi.

Qëllimi i raportit "Varfëria e fëmijëve në Shqipëri" është të inkurajojë vëzhgimin, të lejojë krahasimin dhe të nxisë diskutimin mbi zhvillimin e politikave për të përmirësuar jetën e fëmijëve në nivel vendi, bashkie, komune dhe komuniteti.

Në përputhje me udhëzuesin metodologjik dhe standartet e monitorimit e të vlerësimit, ky raport klasifikohet si "Kartë Raportuese", sepse paraqet kryesisht të dhëna duke shpjeguar edhe kuptimin e tyre, gjë e cila ndihmon lexuesit të ndërmarrin veprime konkrete. Raporti mbështetet në përdorimin e të dhënave të burimeve të ndryshme si: institucionet publike qendrore dhe lokale (Instituti i Shëndetit Publik, Drejtoria Arsimore Rajonale), të dhëna nga studime të ndryshme kombëtare të realizuar në vite (SDSHSH 2008-2009, AMNJ 2008), studime nga ekspertë të ndryshëm si dhe botime të institucioneve të huaja.

Çertifikimi i çdo dimensioni të përbërë nga treguesit e vet përkatës, është një element i munguar në këtë raport, në ndryshim nga rekomandimet e literaturës. Gjatë hartimit të këtij raporti rezultoi e pamundur llogaritja e vlerës mesatare të 26 treguesve, për shkak të mosnjësimit të të dhënave në të njëjtin nivel (qark, bashki, komune).

Krahasimi i çdo treguesi për çdo rajon me mesataren e po këtij treguesi në nivel kombëtar rezultoi gjithashtu i pamundur. Kjo për shkak të mungesës të të dhënave të njësuara për çdo Qark apo njësi vendore të territorit të Shqipërisë për treguesit e mirëqënies sociale. Të dhënat e treguesve të mirëqënies sociale variojnë në varësi të burimit të të dhënave (ndarja territoriale e vendit në nivel qarku apo njësie vendore apo sipas ndarjes së SDSHSH në zona malore, qëndrore, bregdetare dhe kryeqytet).

Raporti përbëhet nga 3 pjesë, përveç hyrjes dhe përmbledhjes. Në *pjesën e parë* paraqitet një analizë e mënyrës se si matet dhe perceptohet varfëria, bazuar në literaturë ndërkombëtare. Në këtë pjesë paraqitet metodologjia e ndjekur në realizimin e këtij raporti dhe kufizimet e tij, duke argumentuar arsyet se pse nuk mund të zbatohen plotësisht rekomandimet e literaturës.

Në pjesën e dytë paraqitet një profil statistikor i vendit, mbështetur në të dhënat më përfaqësuese. Këtu realizohet dhe krahasimi analitik i treguesve sipas literaturës dhe atyre treguesve që janë përdorur në Kartën Raportuese 1 për Shqipërinë. Në pjesën e dytë, tabloja e mirëqenies së fëmijëve në vend, realizohet duke u bazuar në pesë dimensionet: mirëqenia materiale, shëndeti dhe siguria, arsimi, sjellja dhe rreziqet dhe strehimi e mjedisi, të cilët paraqiten në kapituj të veçantë.

Mirëqenia materiale e fëmijëve (kapitulli i parë) matet me deprivimin monetar dhe atë material. Shëndeti dhe siguria e fëmijëve (kapitulli i dytë), si në praktikën ndërkombëtare ashtu dhe në këtë Kartë Raportuese për Shqipërinë, vlerësohet nga tre komponentë: Shëndeti në lindje, Shërbimet parandaluese shëndetësore dhe Vdekshmëria fëminore dhe e

të rinjve. Dimensioni Mirëqenia arsimore e fëmijëve (kapitulli i tretë) identifikon sasinë dhe cilësinë e arsimit të fëmijëve në vend, duke u bazuar në vlerësimin e dy komponentëve: pjesëmarrja dhe arritja. Dimensioni i katërt i mirëqenies së fëmijës, sjelljet dhe rreziqet (kapitulli i katërt), është një nga dimensionet më të vështirë për t'u përcaktuar, në krahasim me dimensionet e tjera. Ky dimension, ndër të tjera, përfshin edhe një gamë të zakoneve dhe sjelljeve kritike për të sotmen dhe të ardhmen e mirëqenies së fëmijëve dhe shoqërisë në tërësi. Komponentët matës të këtij dimensioni, janë ushqimi dhe ushtrimi, sjellja dhe rreziqet, dhe ekspozimi ndaj dhunës. Dimensioni i fundit, mirëqenia mjedisore (kapitulli i pestë)e fëmijëve, vlerësohet nga dy komponentë: strehimi dhe siguria mjedisore.

Në pjesën e tretë, pasqyrohet mirëqenia e fëmijëve nga këndvështrimi i vetë fëmijëve. Kjo pjesë e raportit trajton çështjen e mirëqenies së fëmijëve nga pikëpamja subjektive, shoqëruar edhe me argumentimet analitike përkatëse.

Gjetjet Kryesore

Matja e mirëqënies së fëmijëve sipas pesë dimensioneve evidenton se:

- Shkalla e varfërisë relative dhe shkalla e hendekut të varfërisë për vitet 2005 dhe 2008 kanë ardhur duke u rritur në të gjithë vendin, veçanërisht në zonën malore, në të cilën janë edhe vlerat më të larta. Shkalla e varfërisë relative në zonën malore është 25.6 përqind në vitin 2005 dhe 26.6 përqind në vitin 2008, ndërsa hendeku i varfërisë po në këtë zonë është 5.1 përqind në vitin 2005 dhe 5.6 përqind në vitin 2008.
- Në zonën malore shkalla e vdekshmërisë foshnjore (vdekje/1000 lindje të gjalla) dhe shkalla e vdekshmërisë fëminore (vdekje për 1000 lindje të gjalla të moshës 0 deri në 5 vjeç) janë në vlerat më të larta në krahasim me zonat e tjera të vendit, përkatësisht në vlerat e 38 vdekje/1000 lindje të gjalla dhe 42 vdekje/1000 lindje të gjalla[1]. Përsa i përket peshës së ulët në lindje, rezultatet tregojnë se përqindja e foshnjave të lindura nën 2500 gram është në vlera të larta në zonën bregdetare dhe në Tiranë. Në të dyja këto zona 4.7përqind e foshnjave lindin nën 2500 gram sipas SDShSh, 2008 - 2009.
- Në nivel qarku pjesëmarrja e fëmijëve në arsimin parashkollor (3-6 vjeç) dhe në arsimin e mesëm (mosha 15-18 vjeç), është nën 50 përqind në të gjitha rajonet e Shqipërisë (për vitin 2010 dhe vitin 2012)[2].
- Thuajse 50 përqind e fëmijëve, nuk jetojnë në mënyrë të shëndetshme. Vetëm 44.4 përqind e fëmijëve arrijnë të konsumojnë vaktin ushqimor të mëngjesit në pesë ditë të javës, ndërsa vetëm 30.7 përqind e fëmijëve kryejnë aktivitete fizike. Përsa i përket sjelljeve të rrezikshme rezulton se 4.6 përqind e fëmijëve të moshës 11-15 vjeç raportojnë të jenë pirës të duhanit. Kjo vlerë është më e lartë tek meshkujt (7.5 përqind) sesa tek femrat (2.1 përqind).
- Sipas INSTAT (2008) 71.8 përqind e familjeve shqiptare, jetojnë në një dhomë me 1 ose 2 persona të tjerë ndërkohë që në vendet e OECD nga 26 vende të marra në analizë, në 17 prej tyre, raportohet të jenë më shumë dhoma se individë që jetojnë në të njëjtën shtëpi (UNICEF, 2013).

1 Të dhënat për vdekshmërinë foshnjore dhe fëminore i korrespondojnë periudhës 10-vjeçare që i paraprin studimit SDShSh, 1999-2008

2 Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Korrik 2013.

Përmbajtja

Falenderime 3
Përmbledhje ekzekutive 4
Lista e Figurave 7
Lista e Tabelave 8
Lista e Shkurtimeve 9
Hyrje 11

PJESA E PARË – Metodologjia e matjes së mirëqënies së fëmijëve 13

PJESA E DYTË – Mirëqenia e fëmijës e matur në pesë dimensione 17
Kapitulli 1: Dimensioni i parë – Mirëqenia materiale 17
Kapitulli 2: Dimensioni i dytë - Shëndeti dhe siguria 29
Kapitulli 3: Dimensioni i tretë - Mirëqenia arsimore 37
Kapitulli 4: Dimensioni i katërt - Sjelljet dhe Rreziqet 47
Kapitulli 5: Dimensioni i pestë - Strehimi dhe mjedisi 53

PJESA E TRETË - Fëmijët për mirëqenien e tyre 57
Bibliografia 62

Lista e Figurave

Figura 1:	Niveli i varfërisë relative, 2005 & 2008.	18
Figura 2:	Përqindja e fëmijëve që jetojnë në familje të papuna, 2011.	20
Figura 3:	Numri i familjeve me fëmijë 0-18 vjeç që marrin përfitime, 2011.	21
Figura 4:	Hendeku i varfërisë, 2005 & 2008.	22
Figura 5:	Niveli i hendekut të varfërisë (Rurale&Urbane), 2005 & 2008.	23
Figura 6:	Niveli i ashpërsisë së varfërisë, 2005 & 2008.	24
Figura 7:	Niveli i vdekshmërisë foshnjore.	30
Figura 8:	Numri i vdekjeve, (0-1vjeç) në nivel rrethi.	31
Figura 9:	Pesha e ulët në lindje, 2010.	32
Figura 10:	Pesha e ulët në lindje në nivel bashkie / komune, 2010.	33
Figura 11:	Niveli i imunizimit, 2010.	34
Figura 12:	Niveli i vdekshmërisë fëminore, 2010.	35
Figura 13:	Pjesëmarrja në arsim në fëmijërinë e hershme (qark), 2012.	38
Figura 14:	Pjesëmarrja në arsim në fëmijërinë e hershme (rreth), 2012.	39
Figura 15:	Pjesëmarrja në arsim në fëmijërinë e hershme (bashki/komunë), 2012.	40
Figura 16:	Niveli i pjesmarjes në arsimin e mëtejshëm (qark), 2010.	41
Figura 17:	Niveli i pjesmarjes në arsimin e mëtejshëm (rreth), 2010.	42
Figura 18:	Niveli i pjesmarjes në arsimin e mëtejshëm(bashki/komunë), 2010.	43
Figura 19:	Arritjet arsimore deri 15 vjeç.	44
Figura 20:	Përqindja e fëmijëve mbipeshë.	48
Figura 21:	Përqindja e fëmijëve që hanë mëngjes, 2013.	49
Figura 22:	Përqindja e fëmijëve që konsumojnë fruta, 2013.	49
Figura 23:	Përqindja e fëmijëve që kryejnë aktivitet fizik, 2013.	50
Figura 24:	Hapësira e banimit (m2 /frymë).	54
Figura 25:	Numri i individëve në një dhomë.	55
Figura 26:	Përqindja e fëmijëve që raportojnë se kanë të paktën dy probleme fizike në shtëpi.	55
Figura 27:	Kënaqësia e fëmijëve nga jeta, 2013.	57
Figura 28:	Kënaqësia e fëmijëve nga jeta sipas grupmoshave, 2013.	58
Figura 29:	Lehtësia e fëmijëve për të folur me prindërit, 2013.	59
Figura 30:	Lehtësia e fëmijëve për të folur me prindërit sipas grupmoshave, 2013.	60
Figura 31:	Numri i miqve të mirë, 2013.	60

Lista e Tabelave

Tabela 1:	Pesë dimensionet dhe treguesit e tyre të mirëqenies materiale të fëmijës në Shqipëri.	14
Tabela 2:	Vlerësimi i mirëqenies materiale.	17
Tabela 3:	Vlerësimi i mirëqenies materiale për Shqipërinë.	17
Tabela 4:	Përqindja e fëmijëve që jetojnë në familje të papuna e ndarë sipas vendbanimit.	19
Tabela 5:	Përqindja e familjeve me fëmijë që marrin përfitime ekonomike.	20
Tabela 6:	Fëmijët që jetojnë në familje që marrin ndihmë ekonomike për një periudhë prej më shumë se tre vite.	21
Tabela 7:	Vlerësimi i shëndetit dhe sigurisë.	29
Tabela 8:	Vlerësimi i shëndetit dhe sigurisë për Shqipërinë.	29
Tabela 9:	Vlerësimi mirëqenies arsimore sipas standartit ndërkombëtar.	37
Tabela 10:	Vlerësimi mirëqenies arsimore për Shqipërinë.	37
Tabela 11:	Vlerësimi i sjelljeve dhe rreziqeve.	47
Tabela 12:	Vlerësimi i mirëqenies mjedisore.	53
Tabela 13:	Vlerësimi i mirëqenies mjedisore për Shqipërinë.	53

Lista e Shkurtimeve

AMNJ	Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës
ASHMDF	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
BB	Banka Botërore
BKTF	Sëbashku kundër trafikut të fëmijëve
BMI	Indeksi i Masës Trupore
CHR	Vdekshmëria fëminore
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
IKU	Instituti i Kërkimeve Urbane
IMR	Vdekshmëria foshnjore
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
MASH	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
MF	Ministria e Financave
MICS	Studimi shumë faktorial mbi gjendjen e fëmijëve
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
NE	Ndihmë Ekonomike
NjQV	Njësi e qeverisjes vendore
OECD	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik
OMZh	Objektivat e Mijëvjeçaritpër zhvillim
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
QKSS	Qendra Kombëtare për Studime Sociale
SDSHSH	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZA	Zyra Arsimore

Hyrje

Pasqyra e vërtetë e një vendi janë fëmijët e tij, shëndeti dhe siguria e tyre, mirëqënia e tyre materiale, arsimi dhe shoqërizimi, gjallëria dhe gëzimi i tyre, liria dhe vlerësimi që ata gëzojnë në familjet e tyre dhe në shoqëri.

(Karta Raportuese 7, UNICEF Innocenti, 2007)

Të drejtat e fëmijëve janë gjithmonë çështje të ndjeshme të institucioneve dhe shoqërisë. Në qarqe të ndryshme të vendit, fëmijët përjetojnë përjashtim, shfrytëzim, dhunë dhe abuzim.Ata janë të shtyrë nga prindërit e tyre apo edukatorët në punë të ndryshme të stinës dhe në disa raste në kushte të patolerueshme; ata po humbasin cilësinë e duhur të arsimit; fëmijët në familje shumë të varfra, jetojnë me mungesën e të drejtave themelore, si: ushqim të shëndetshëm, kujdes shëndetsor cilësor, arsimim cilësor etj.

Karta Raportuese "Varfëria e Fëmijëve në Shqipëri" ofron një pamje të shpejtë të fëmijërisë në Shqipërinë e sotme, duke paraqitur problemet më kritike të më të përjashtuarëve të Shqipërisë. Ky raport ka zgjedhur të analizojë angazhimet themelore në fusha specifike të mirëqenies materiale, shëndetit dhe sigurisë, arsimit, sjelljes dhe rreziqeve, dhe strehimit e mjedisit. Këto fusha u zgjodhën sepse konstatohet se këto fusha përkojnë me angazhimet prioritare të qeverisë. Nga ana tjetër, progresi në këto drejtime është i matshëm. Raporti synon të ndikojë në nxitjen e vëzhgimit, lejimin e krahasimit dhe stimulimin e diskutimeve, me qëllim zhvillimin e politikave për të përmirësuar jetën e fëmijëve.

Deklarata e Mijëvjeçarit e vitit 2000 në mënyrë të qartë trajton nevojën për të mbrojtur fëmijët nga dhuna, konflikti, abuzimi dhe shfrytëzimi.Me miratimin e deklaratës, të gjitha vendet, përfshirë edhe Shqipërinë, janë të angazhuara për të zgjidhur:

- Përpjekjen për mbrojtjen e plotë dhe promovimin e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore për të gjithë.
- Luftën ndaj të gjitha formave të dhunës kundër grave dhe zbatimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave.
- Garantimin që fëmijët dhe të gjitha popullsitë civile, të cilat në mënyrë disproporcionale vuajnë pasojat e katastrofës natyrore, gjenocidit, konfliktit të armatosur dhe të emergjencave të tjera humanitare,t'u jepet çdo ndihmë dhe mbrojtje në mënyrë që ata të mund të ri-integrohen sa më shpejt të jetë e mundur.
- Nxitjen e ratifikimit dhe zbatimit të plotë të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës dhe Protokolleve të saj Opsionale mbi Përfshirjen e Fëmijëve në Konflikte të Armatosura dhe mbi Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin e Fëmijëve dhe Pornografinë e Fëmijëve.

Mbrojtja e fëmijëve është komponent i secilit nga Objektivat e Mijëvjeçarit për Zhvillim (OMZh-të) – nga reduktimi i varfërisë deri në arsimimin e fëmijëve, nga eleminimi i pabarazisë gjinore në uljen e vdekshmërisë fëminore.Për të konkretizuar këtë ide, vërejmë se puna e fëmijës parandalon, shtyn dhe kufizon futjen në arsim (OMZh 2), ndërsa arsimimi i cilësisë së dobët kontribuon në largimin e fëmijëve nga shkolla dhe futjen në punë.Vajzat kanë më shumë të ngjarë që të largohen nga shkolla për të bërë punë shtëpie (OMZh 3) dhe vajzat që u mbijetojnë shfrytëzimit seksual janë më të prirura ndaj sëmundjeve që do të kërcënojnë jetën apo shëndetin e tyre prej nëne (OMZh 5 dhe 6).Martesa e fëmijës çon në

largimin e vajzave nga shkolla dhe shmang barazinëgjinore (OMZh 2 dhe 3); ajo gjithashtu çon në shtatzëni të hershme, e cila mbart rreziqe të konsiderueshme shëndetësore për vajzat (OMZh 5) dhe foshnjat e tyre (OMZh 4).

Një mjedis mbrojtës që përfshin të gjitha fushat e jetës shoqërore – ku ligjet, shërbimet, sjelljet dhe praktikat zvogëlojnërreziqet me të cilat përballen fëmijët, si dhe forcojnë elasticitetin e tyre – mund të parandalojë ndodhinë e shumë formave të dhunës, shfrytëzimit dhe abuzimit.

Mbrojtja dhe promovimi i mirëqenies së fëmijëve nuk është thjesht një detyrim moral siç e thekson dhe raporti, por edhe pragmatik. Dështimi në këtë drejtim mund të shkaktojë rreziqe në rritje në një gamë të gjerë të rezultateve në jetën e mëvonshme, si edhe në atë të komuniteteve dhe vendeve të tyre.

Karta Raportuese 1 shqyrton gjendjen e fëmijëve në Shqipëri. Ai paraqet arritjet dhe dështimet e shoqërisë shqiptare në garantimin e mirëqenies së fëmijëve të tyre gjatë viteve më të fundit. Karta Raportuese 1 mat zhvillimin sipas pesë dimensioneve të mirëqenies së fëmijëve - mirëqenia materiale, shëndeti dhe siguria, arsimi, sjellja dhe rreziqet, dhe strehimi dhe mjedisi. Ndër të tjera ky raport gjithashtu përfshin pikëpamjet e vetë fëmijëve për kënaqësinë nga vetë jeta e tyre.

«Duhet të dimë më shumë për mënyrën se si fëmijët i shohin dhe vlerësojnë jetët e tyre,» thotë Gordon Alexander (UNICEF, 2013) «se çfarë ka rëndësi për ata dhe duhet ta bëjmë këtë në një mënyrë më sistematike». Zërat e fëmijëve, edhe në një moshë shumë të re, janë jetikë. Ato theksojnë mesazhin e kësaj Karte Raportuese të parë: se qeveritë duhet t›i drejtojnë politikat në një mënyrë të atillë që do të mbrojnë të ardhmen afat-gjatë të fëmijëve dhe mirëqenien e tyre.

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë dhe po zbaton një reformë komplekse sociale e cila synon forcimin e mekanizmave institucionalë për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), e nënshkruar nga Shqipëria në Mars 1991 shërben si udhërrëfyes për hartimin e legjislacionit që mundëson garantimin në praktikë të të drejtave të fëmijëve, i cili kulmon me miratimin e Ligjit Nr.10347, datë 4.11.2010, "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës". Ky ligj vendos themelin për ngritjen e mekanizmave të përshtatshëm institucionalë që do të garantojnë dhe sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve nga individët, familja, dhe shteti. Ligji siguron të gjitha masat e nevojshme për garantimin e jetës, mirërritjes dhe zhvillimit të fëmijës nëpërmjet një qasje të koordinuar ndërmjet aktorëve të ndryshme që punojnë në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës.

Pavarësisht arritjeve, është e domosdoshme që Ligji mbi Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të zëvëndësojë legjislacionin egzistues dhe të sigurojë hartimin e politikave dhe strategjive gjithpërfshirëse. Në këtë kontekst, edhe Plani i Veprimit për Fëmijë 2012-2015 si shprehje e politikave përfshirëse të fëmijëve, duhet të përfshijë të gjithe planet e veprimit për fëmijë, sektoriale apo rajonale. Nga ana tjetër duhen rritur përpjekjet për të siguruar të gjitha burimet njerëzore, teknike dhe financiare për një zbatim efektiv të tij.

Ndërsa roli koordinues i Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve duhet të forcohet, përpjekjet për ndërtimin e një sistemi të plotë për mbledhjen e të dhënave, duhen intensifikuar. Miratimi i VKM-ve 263-267 mundëson ngritjen dhe forcimin e një sistemi institucional të monitorimit dhe raportimit periodik e të vazhdueshëm të zbatimit të të drejatve të fëmijëve në nivel kombëtar, rajonal e lokal. Në mënyrë të veçantë, miratimi i VKM 267 datë 12.04.2012 "Mbi llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore në nivel qendror dhe vendor" krijon kushtet për matjen e efektivitetit të politikave të mirëqenies sociale të fëmijëve duke u mbështetur në analizën e treguesve të sapo miratuar.

Pjesa 1

METODOLOGJIA E MATJES SË MIRËQËNIES SË FËMIJËVE

1.1 Kuptimi mbi matjen e mirëqenies së fëmijëve

Tradicionalisht, koncepte të tilla si "cilësia e jetës" dhe "mirëqenia" janë matur në mënyrë indirekte, duke përdorur faktorë të tjerë si: të ardhurat familjare, jetëgjatësia dhe kështu me radhë. Në mënyrë tipike, këto lloje faktorësh janë objektivë, sepse ato bazohen në fenomene të vrojtueshme në botë që mund të llogariten lehtë (p.sh., pagat dhe nivelet e borxhit, nivelit e vdekshmërisë etj).

Megjithatë, diskutimet e fundit rreth mirëqenies janë fokusuar në përdorimin e treguesve subjektivë– që do të thotë, treguesit e bazuar në vetë-raportimet e individëve si psh nëse ata ndjehen të lumtur, të kënaqur dhe të plotësuar në jetën e tyre të përditshme.Edhe pse ka pasur një shkallë të caktuar të kujdesit të shprehur në lidhje me këto lloje matjesh, tani është pranuar gjithnjë e më shumë që ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm kur zbatohen dhe interpretohen me kujdes[3].

Treguesi i vendosur i mirëqenies së fëmijës mund të përdoret për qëllime të ndryshme të cilat përfshijnë përshkrimin, monitorimin, vendosjen e objektivave, llogaridhënien dhe vlerësimin. Qëllimi i treguesve të mirëqenies së fëmijës është të:

- Mundësohet paraqitja grafike e gjendjes së fëmijëve në vend;
- Ndryshohet rruga e ndjekur kohë pas kohe;
- Nënvizohet progresi;
- Identifikohen probleme politike, çështje apo dështime.

Treguesit e mirëqenies së fëmijës janë konsideruar veçanërisht të dobishëm për të përshkruar gjendjen e fëmijëve dhe për të lejuar krahasimet ndërmjet fëmijëve me prejardhje të ndryshme. Identifikimi i grupeve të fëmijëve që janë në rrezik apo në disavantazh krahasuar me të tjerët është një hap i rëndësishëm në zhvillimin e ndërhyrjeve dhe/ose të shërbimeve parandaluese për të promovuar mirëqenien e tyre. Gjithashtu, identifikimi i grupeve të fëmijëve që kanë shmangur rrezikun jep një pasqyrë të asaj se çfarë funksionon për t'i dhënë fëmijëve jetë më të mirë.

Treguesit e mirëqenies së fëmijës shërbejnë gjithashtu si mjete të rëndësishme për ndjekjen e rezultateve të fëmijës me kalimin e kohës dhe kjo lejon vendosjen e tendencave në të ardhmen.Treguesit e mirëqenies së fëmijës janë pranuar gjithashtu gjithnjë e më shumë si mjete të rëndësishme për planifikimin dhe krijimin e politikave, sepse mund të sigurojnë hartuesit e politikave, planifikuesit dhe ofruesit e shërbimeve me bazë empirike për vendim-marje në çdo fazë të procesit.Kjo përfshin, mundësimin e identifikimit të zonave në nevojë dhe/ose prioritare, shpërndarjen e burimeve të kufizuara në mënyrë më efektive, vendosjen e objektivave, zhvillimin dhe zbatimin e programeve dhe politikave që mund të adresojnë nevoja specifike të grupeve të ndryshme të fëmijëve.

3 NEF (2009),A guide to measuring children's well-being, Practical guide 2; (http://www.actionforchildren.org.uk/media/94477/action_for_children_a_guide_to_measuring_childrens_well_being.pdf)

Treguesit e mirëqenies së fëmijëve përdoren gjithashtu për të vlerësuar suksesin dhe dështimin e politikave, nëse po bëhet progres drejt objektivave sociale dhe nëse po bëhen investimet e burimeve në programet e përzgjedhura, shërbimet dhe iniciativate tjera.

Si përfundim, ekzistojnë një numër arsyesh të ndryshme në përzgjedhjen e treguesve mbi mirëqenien e fëmijës në rang vendi.Në nivelin më elementar, ato lejojnë krahasimin gjatë periudhave të ndryshme kohore dhe midis (e brënda) komuniteteve të ndryshme të fëmijëve. Kur përdoren me potencialin e tyre më të madh, ato mundësojnë "shoqëritë për të informuar politikat e tyre, të nxisin dhe shpërblejnë përpjekjet, të shënojnë arritjen e tyre, të paraqesin llogaridhënie dhe të jenë një mjet me të cilin presioni i qëndrueshëm mund të sjellë qëndresë për përmbushjen e premtimeve politike"[4].

Në literaturën e hershme ekonomike, ekonomistët tradicionalisht barazonin mirëqenien me kushtet materiale individuale si të ardhurat dhe pasuria. Megjithatë, është pranuar gjithnjë e më shumë brënda komunitetit të mendimit ekonomik që ekzistojnë komponentë shtesë në vlerësimin e mirëqenies (duke përfshirë, për shembull, shëndetin, arsimimin dhe marrëdhëniet shoqërore) dhe kjo në krahun tjetër ka çuar në pranimin e faktit se kushtet materiale nuk përbëjnë tërësinë e mirëqenies. Megjithatë, ka një supozim të vazhdueshëm se në qoftëse të ardhurat rriten ndjeshëm, atëherë mirëqenia e përgjithshme do të lëvizë në të njëjtin drejtim[5].

Karta Raportuese"Varfëria e Fëmijëve në Shqipëri" është përgatitur në bazë të pesë dimensioneve dhe 26 treguesve. Mirëqenia materiale e fëmijëve është ndërtuar dhe parashtron listën e plotë të treguesve të përdorur, si më poshtë:

Tabela 1: Pesë dimensionet dhe treguesit e tyre të mirëqenies materiale të fëmijës në Shqipëri

Dimensionet	Komponentët	Treguesit	Rreth Shqipërisë
Dimensioni 1– Mirëqenia materiale	Deprivimi monetar	Niveli i varfërisë relative fëminore	Po
		Hendeku i varfërisë relative fëminore	Po
	Deprivimi material	Niveli i deprivimit të fëmijës	Jo
		Nivelii pasurisë (kamjes) së ulët të familjes	Jo
Dimensioni 2 – Shëndeti dhe siguria	Shëndeti në lindje	Niveli i vdekshmërisë foshnjore.	Po
		Pesha në lindje	Po
	Shërbime parandaluese shëndetësore	Niveli i përgjithshëm i imunizimit	Po (18-29 muajsh)
	Vdekshmëria fëminore	Nivelii vdekshmërisë fëminore, mosha 1-19 vjeç	Po (0-5 vjeç)
Dimensioni 3 –Arsimi	Pjesëmarrja	Niveli i pjesëmarrjes: Arsimi në fëmijërinë e hershme	Po
		Niveli i pjesëmarrjes: arsimi i mëtejshëm mosha 15-19 vjeç	Po (15-18 vjeç)
		Niveli NEET (përqind të moshës 15-19 vjeç në arsim, punësim ose trajnim)	Po (15-17 vjeç)
	Arritja	Rezultatet mesatare të PISA-s në lexim, matematikë dhe shkencë	Po

4 Brooks, Anne-Marie dhe Sinéad Hanafin (2005), Raporti mbi Zhvillimin Kombëtar të Treguesve të Mirëqenies së Fëmijëve në Irlandë, fq.14

5 Njëlloj;

Dimensionet	Komponentët	Treguesit	Rreth Shqipërisë
Dimensioni 4 – Sjelljet dhe rreziqet	Sjelljet shëndetësore	Të qenit mbi peshë	Po
		Ngrënia e mëngjesit	Po
		Ngrënia e frutave	Po
		Bërja e ushtrimeve	Po
	Sjellje të rrezikshme	Nivelii fertilitetit tek adoleshentët	Po
		Duhanpirja	Po
		Alkooli	Po
		Droga (Kanabis)	Po
	Ekspozimi ndaj dhunës	Zënkat	Po
		Tallja	Po
		Të qenit i tallur	Po
Dimensioni 5 – Strehimi dhe mjedisi	Strehimi	Dhoma për person	Po
		Problemet e strehimit të mbipopulluar	Po (të paktën 2 probleme)
	Siguria mjedisore	Nivelii vrasjeve	Po
		Ndotja e ajrit	Po (tonë metrikë për frymë)

1.2 Kufizime të Kartës Raportuese – Shqipëri

Të dhënat e krahasueshme për treguesit e mirëqenies s ëfëmiëjve sipas tabelës së mësipërme nuk jepen mjaftueshëm në kohë. Hapësira kohore ndërmjet mbledhjes së të dhënave në një shumëllojshmëri të gjerë të zonave të ndryshme dhe publikimit të tyre me cilësi të kontrolluar është zakonisht dy deri në tre vite. Kjo do të thotë se shumica e statistikave për mirëqenien e fëmijëve të përdorur në këtë raport, i përket periudhës 2008-2012. Vonesa në kohë vjen si rezultat i vonesës së institucioneve në publikimin e të dhënave me të paktën një vit. E dyta është se disa prej të dhënave disponohen vetëm nga anketat, të cilat bëhen publike një herë në 3-4 vjet (anketa SDSHSH). Një tjetër arsye është se disa prej të dhënave disponohen vetëm nga institucionet ndërkombëtare (Banka Botërore ose OECD, etj).

Pavarësisht kësaj, në pjesën më të madhe, të dhënat e përdorura pasqyrojnë rezultatet e investimeve afatgjata në përmirësimin e jetës dhe mirëqenies së fëmijëve. Nivelet mesatare të arritjeve në shkollë ose nivelit e imunizimit janë matës të ndryshimit afatgjatë nëmirëqenien e fëmijëve.

Një tjetër kufizim është se disa prej të dhënave nuk mund të krahasohen në nivel qarku, sepse vlerësimi i treguesve specifikë bëhet vetëm në nivel kombëtar, të tillë si treguesit e përmendur në dimensionin 5 «Strehimi dhe mjedisi».

Një tjetër problem është krahasimi i të dhënave në nivel ndërkombëtar. Krahasimi ndërkombëtar është ëai që tregon se çfarë është e arritshme në botën reale, thekson pikat e forta dhe dobësitë në vendet individuale dhe tregon se mirëqeniae fëmijëve është e ndjeshme ndaj politikave. Problem në Shqipëriështë ende mungesae unifikimit të treguesve që masin mirëqenien e fëmijëve. Shqipëria ende nuk ka tregues të cilët të jenë të unifikuar me vendet e BE-së dhe si pasojë mungojnë ende standardet e krahasimit.

Treguesit për të cilët nuk janë arritur të mblidhen të dhëna dhe të prezantohen në këtë Kartë Raportuese për Shqipërinë, janë: niveli e deprivimit të fëmijës dhe niveli e pasurisë së ulët të familjes. Të dy këta tregues janë pjesë e komponentit "Deprivimi material"[6].

6 Për më shumë detaje mund t'i referoheni tabelës 1:

Treguesit të cilët raportohen nga institucionet përkatëse në Shqipëri, por që nuk janë në të njëjtin parametër matës me treguesit globalë të përdorur në Kartat Raportuese të hartuara nga vendet e zhvilluara, janë:

- niveli i imunizimit të përgjithshëm (për Shqipërinë matet për periudhën moshore 18-29 muajsh ndërsa për vendet e zhvilluara raportohet për periudhën moshore 12-23 muajsh)
- vdekshmëria fëminore (për Shqipërinë matet për grupmoshën 0-5 vjec, ndërsa për vendet e zhvilluarapër grupmoshën 1 – 19 vjeç)
- shkalla e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm (për Shqipërinë matet për grupmoshën 15-18 vjeç, ndërsa për vendet e zhvilluara raportohet për grupmoshën 15 – 19 vjeç)
- niveli NET (për Shqipërinë matet për grupmoshën 15-17 vjeç, ndërsa për vendet e zhvilluara raportohet për grupmoshën 15 – 19 vjeç)
- ndotja e ajrit për Shqipërinë matet me tonë metrikë për frymë, ndërsa për vendet e zhvilluararaportohet me µg/m37)

1.3 Metodologjia për realizimin e Kartës Raportuese 1

Karta Raportuese 1 për Shqipërinë, është realizuar duke u mbështetur në modelin e Kartës Raportuese 11 (UNICEF, Research Center Innocenti). Raporti paraqit të dhënat mbi varfërinë dhe mirëqenien e fëmijëvetë vlerësuar në pesë dimensione, analizon kuptimin e dimensioneve dhe treguesve përkatës duke u bazuar kryesisht në standarte ndërkombëtar.

Të dhënat kryesore të këtij raporti, bazohen në të dhëna të institucioneve publike qendrore dhe lokale, siç janë: INSTAT, MASH, Instituti i Shëndetit Publik, Ministria e Brendshme, MPÇSSH, DAR dhe ZA.

Të dhëna të tjera të këtij raporti janë marrë dhe nga literatura dhe studime të huaja dhe vendase, të lidhura me këtë temë, si: Karta Raportuese të hartuara në vite të ndryshme, SDSHSH 2008-2009, AMNJ 2008; studimi i matjes së përjashtimit social të fëmijëve në Shqipëri (V. Kolpeja, 2011), studim i profilit të varfërisë së fëmijëve (A.Ceni, 2011), Raporti i Progresit i vitit 2012 për Shqipërinë.

Burim shumë i dobishëm informacioni për hartimin e analizës së këtij raporti, janë dhe raportet e hartuara në vite të ndryshme nga organizata partnere që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, si: BKTF, Terre des Hommes etj. Ekspertët e Observatorit në çdo qark, kanë shërbyer si burim informacioni , duke mundësuar përcjelljen e rasteve, të cilat ndihmuan në krijimin e një analize krahasuese ndërmjet përvojave reale të jetës dhe treguesve të ndryshëm numerikë.

Duke konsideruar rëndësinë e këtij raporti, ekspertët janë përpjekur të kapërcejnë vështirësitë e shkaktuara nga kufizimet e të dhënave. Megjithatë pranohet mungesa e një informacioni më të përshtatshëm në përmbajtje dhe në aspektin kohor. Disa tregues nuk janë matur së afërmi, si për shembull, treguesi i varfërisë relative të fëmijëve nuk është matur që nga viti 2005.

7 Përqendrimi i një ndotësi të ajrit (p.sh. ozoni) jepet në mikrogramë (një e milionta e një grami) për metër kub ajri ose µg/m3

Pjesa 2

MIRËQENIA E FËMIJËS E MATUR NË PESË DIMENSIONE

Kapitulli 1 Dimensioni i parë – Mirëqenia materiale

Mirëqenia materiale është një dimension i mirëqenies njerëzore. Mirëqenia materiale matet nëpërmjet të ardhurave, modeleve të konsumit ose pasurisë. Në vendet në zhvillim, pasuritë e njerëzve të varfër shpesh përfshijnë tokën ose bagëtinë.Nuk ekziston përkufizim unik, por koncepti më shpesh mendohet si përfaqësues i rezervave të pasurisë të përdorura për të krijuarmirëqenie. Pronarët e kapitaleve zakonisht nuk i dinë vlerat e pasurive të tyre sepse nuk kanë informacion të indekseve të çmimeve të konsumit ose sepse ata nuk janë në gjendje të raportojnë pronësinë e tokës në sipërfaqe të kultivuar, prandaj matja kapitaleve/pasurisëmbetet një sfidë8.

Literatura rekomandon se *mirëqenia materiale* e fëmijëve vlerësohet nga dy komponentë: deprivimi monetar dhe deprivimi material.

Secili prej këtyre komponenteve ka treguesit e vet, siç tregohet në tabelën më poshtë.

Tabela 2: Vlerësimi i mirëqenies materiale

Komponentët	Treguesit
Deprivimi monetar	Niveli i varfërisë relative fëminore (përqindja e fëmijëve që jetojnë në familje me të ardhura ekuivalente nën 50 përqind të mesatares së vendit)
	Hendeku i varfërisë fëminore (distanca midis vijës së varfërisë në rang vendi dhe të ardhurave mesatare të familjeve nën vijën e varfërisë)
Deprivimi material	Treguesi i deprivimit të fëmijëve (përqindja e fëmijëve që iu mungojnë artikuj të veçantë)
	Shkalla e pasurisë së familjes (përqindja e fëmijëve që raportojnë pasuri të ulët të familjes)

Nëse përdorim këtë tabelë për të marrë një pasqyrë rreth situatës shqiptare, rezulton se (tabela 3):

Tabela 3: Vlerësimi i mirëqenies materiale për Shqipërinë

Komponentët	Treguesit
Deprivimi monetar	Niveli i varfërisë relative (përqind e njerëzve që jetojnë në familje me konsum më pak se 60përqind e mesatares së vendit)
	Hendeku i varfërisë (distanca midis vijës së varfërisë kombëtare e familjeve nën vijën e varfërisë)
Deprivimi material	Indeksi i deprivimit të fëmijës–nuk matet në Shqipëri
	Shkalla e pasurisë (kamjes) së familjes–nuk matet në Shqipëri

8 Ky përkufizim është i bazuar në fjalorin Wikiprogress , http://www.wikiprogress.org/index.php/well-being

1.1 Deprivimi monetar

Sfida e parë për çdo qeveri që kërkon të reduktojë varfërinë fëminore është që të krijojë një konsensus se si mund të përkufizohet e matet mëmirë ajo. A nënkupton varfëria pamundësinë për të blerë gjërat e domosdoshme si ushqimi, veshjet, strehimi dhe kujdesi shëndetësor? Apo do të thotë të mbetesh mbrapa për sa i përket të ardhurave dhe stilevetë jetës së komunitetit në të cilin jeton një njeri? Ku duhet të vihet vija midis të varfërve dhe jo të varfërve?Dhe si duhet përditësuar vija e varfërisë?Pyetje të tilla provokojnë polemika jo vetëm mes akademikëve dhe studiuesve por edhe ndërmjet politikanëve, shtypit dhe publikut. Duke mos pasur asnjë përgjigje – përgjigje që mund të sjellin një shkallë konsensusi– treguesit nuk mund të krijohen, objektivat nuk mund të vendosen, progresi nuk mund të monitorohet dhe politika nuk mund të vlerësohet[9].


Treguesit e përdorur në këtë raport për të matur deprivimin monetar janë: Niveli i varfërisë relative, niveli i varfërisë absolute, përqindja e fëmijëve që jetojnë në familje me prindër të papunë dhe me ndihmë ekonomike, si edhe fëmijë të familjeve në varfëri konstante.

Niveli i varfërisë fëminore

Niveli i varfërisë relativetregon përqindjen e familjeve të secilit vend me konsum më pak se 60 përqind të mesatares së vendit. Për shumicën e ekonomive të zhvilluara të botës niveli e varfërisë në mënyrë specifike për fëmijët matet me nivelin e varfërisë relative fëminore, e cila sipas përkufizimit është fëmijë që jetojnë në familje ku të ardhurat e disponueshme janë më pak se 50 përqind të mesatares së vendit (pas marrjes në konsideratë të përllogaritjes së taksave dhe përfitimeve dhe përshtatjes me madhësinë dhe përbërjen e familjes). Ky tregues i veçantë nuk matet në Shqipëri.

Nuk ka ende një standardizim të treguesve dhe në këtë mënyrë është mjaft e vështirë për të krahasuar vlerat dhe për tëparë përparimin ose kthimin pas në Shqipëri. Në Shqipëri niveli e varfërisë relative matet me përqindjen e njerëzve që jetojnë në familje me nivel konsumi më pak se 60 përqind e mesatares kombëtare. Këta individë përbëj në grupin i cili është shumë i rrezikuar nga varfëria dhe që përjeton pabarazinë më të thellë. Figura 1 tregon nivelin e varfërisë në Shqipëri sipas rajoneve për 2005 dhe 2008.

Figura 1: Niveli i varfërisë relative, 2005/2008



Burimi: A. Ceni, 2011

9 Raporti Card Nr.6 i Fëmijës- Varfëria në vendet e pasura 2005, përqindja e fëmijëve që jetojnë në varfëri është rritur në shumicën e ekonomive të zhvilluara të botës.UNICEF, Qëndra Kërkimore Innocenti , Firence 2005.

Krahas kësaj logjike varfëria e fëmijëve mund të matet edhe në terma absolute, që presupozon aksesin ndaj një niveli minimum i të ardhurave dhe burimeve monetare të nevojshme për mbijetesë. Zakonisht në publikimet e statistikave të vendeve të ndryshme, konsiderohet i varfër një fëmijë që varet nga një familje niveli i jetesës i së cilës është mesatarisht gjatë një viti, më i ulët se një kufi i quajtur i varfërisë.[10] Ky pëkufizim është i kundërshtueshëm, por realisht ai është sot një tregues i pazëvendësueshëm për paraqitjen e të dhënave sistematike.

Burimi kryesor që përdoret për të matur varfërinë në rang kombëtar të familjeve dhe të personave të ndryshëm është anketa e kryer mbi AMNJ. Kjo ndihmon institucionet përkatëse që të ndërtojnë një sistem treguesish të krahasueshëm vit pas viti. Objektivi i pasjes në dispozicion të këtij burimi është që të përftohen rezultate në vitin n+2. Nga ana tjetër këto të dhëna përmbajnë një numër çështjesh që duhen komentuar. Për nevoja të llogaritjes së këtij treguesi, grupi i ekspertëve iu referua të dhënave të cilat janë parashikuar nga UNICEF për analizën e varfërisë së fëmijëve dhe ndonjë të dhëne tjetër plotësuese.

Treguesi i përqindjes së fëmijëve që jetojnë në varfëri absolute sipas AMNJ-së me zero dollarë të ardhura) është 1. 8 përqind, ndërsa fëmijë që jetojnë në familje me më pak se 120 USD në muaj (që do të thotë me më pak se 1 USD në ditë për person) janë 17. 14 përqind.

Përqindja e fëmijëve që jetojnë në familje të papuna është një tregues tjetër që reflekton varfërinë monetare. Familjet e papunë janë një njësi ekonomike dhe shoqërore me të ardhura të ulëta ose pa të ardhura. Familje të tilla sipas rajoneve paraqiten në tabelën 4:

Tabela 4: Përqindja e fëmijëve që jetojnë në familje të papuna e ndarë sipas vendbanimit, 2011

Rajonet	Përqindja e fëmijëve që jetojnë në familje të papuna
Tirana	6. 31
Rajoni Malor	13. 48
Rajoni Bregdetar	5. 97
Rajoni Qëndror	7. 97


Burimi: A. Ceni, 2011

Të ardhurat e tyre mund të jenë ato, të cilat vijnë ose nga ndihma ekonomike ose nga ndonjë transferim parash nga jashtë. Në kushtet aktuale ku remitancat nga jashtë po vijnë duke u ulur, atëherë edhe ky aspekt i varfërise monetare duhet analizuar me kujdes.

Situata shumë kritike paraqitet në rrethet Kurbin (Laç), Pukë, Mirditë, Kukës dhe Bashkia Kamzë, ku përqindja e këtyre fëmijëve që jetojnë në familje të papuna është mbi 20 përqind, madje i afrohet nivelit 30 përqind. Siç tregon edhe figura 2, më të varfër paraqiten fëmijët e zonave veriore gjë që përputhet edhe me realitetin e vështirë të këtyre fëmijëve që punojnë në rrugë ose si shitës ambulant.

10 Sipas disa praktikave boterore niveli I jetesës përbëhet nga të ardhurat e disponueshme të familjes, e pjestuar me madhësinë e saj të shprehur në njësi konsumi. Njësitë e konsumit llogariten duke e konsideruar personin e parë më një, të tjerët nga mosha 14 vjeç e lart me o.5 dhe të tjerët më të vegjël se 14 vjeç me o.3. Në Shqiperi nuk përdoret kjo metodike.

Figura 2: Përqindja e fëmijëve që jetojnë në familje të papuna, 2011



Burimi: A. Ceni, 2011

Numri i familjeve me fëmijë 0-18 vjeç që marrin përfitime më qëllim që të kompensojnë gjendjen e tyre të papunësisë paraqitet në tabelën 5:


Tabela 5: Përqindja e familjeve me fëmijë që marrin përfitime ekonomike

Rajonet	Përqindja e familjeve që marrin përfitime
Tiranë	33.97
Malore	68.35
Bregdet	42.85
Qëndrore	54.31

Burimi: A. Ceni, 2011

Siç konstatohet, numri i familjeve që marrin përfitime është i konsiderueshëm. Po të analizohet ky problem lidhur me rrethet e ndryshme konstatohet se në rrethe (figura 3) të tilla si Lezha, Kurbini, Kavajë, Mallakastër, Pogradeci, Mirdita, Puka, Mati, dhe Bashkia Kamzë, numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike është nga dy deri në katër herë më shumë se sa në rrethet e tjera.

Figura 3: Numri i familjeve me fëmijë 0-18 vjeç që marrin përfitime, 2011



Burimi: A. Ceni, 2011

Varfëria afatgjatë e fëmijëve mund të karakterizohet edhe tek numri i familjeve që marrin ndihme ekonomike për një periudhë mbi tre vite dhe që kanë fëmijë.

Tabela 6: Fëmijët që jetojnë në familje që marrin ndihmë ekonomike për një periudhë prej më shumë se tre vite.[11]

Rajonet	Përqindja e fëmijëve që jetojnë në familje që marrin ndihme ekonomike për më shumë se tre vjet
Tiranë	0.8
Malore	87.9
Bregdet	3.2
Qendrore	8.1
Totali	100.0

Burimi: A. Ceni, 2011

11 Ky tregues llogaritet si raport I numrit të fëmijëve që jetojnë në familje që marrin ndihme prej me shum se tre vite, me numrin e fëmijëve të tillë në total. Pra ky është një tregues I strukturës.

Varfëria afatgjatë është treguesi më negativ për fëmijët, sepse pranohet dhe provohet shkencërisht që varfëria afatgjatë ndikon në formimin e tyre. Kjo lloj varfërie quhet dhe varfëri konstante, e cila duhet ulur me të gjitha mënyrat e mundshme.


Gjetjet:

- Në nivel vendi nivelii varfërisë relative 2005-2008 ka pasur njër ulje prej 6. 1 përqind. Kjo ulje është ndikuar kryesisht nga zona bregdetare dhe qendrore, për shkak se ato të dyja kanë pasur një ulje në nivelin e varfërisë relative nga viti 2005 deri në vitin 2008. Përkatësisht zona qendrore ka pasur një ulje prej 10. 5 përqind dhe zona bregdetare ka pasur një ulje prej 3. 2 përqind.
- Nivelii varfërisë relative ka pësuar rritje në Tiranë dhe në zonën malore, përkatësisht me 0. 8 dhe 1 përqind.
- Sipas treguesit të varfërisë absolute, 17,14 përqind e fëmijëve jetojnë në varfëri absolute, ndërsa 1,2 përqind jetojnë në varfëri ekstreme.

1.1.1. Hendeku i varfërisë

Hendeku i varfërisë tregon se ç'përqindje e familjeve jetojnë nën vijën e varfërisë së çdo vendi. Ky tregues është shuma e të gjitha diferencave të konsumit të familjeve të varfëra nga niveli i varfërisë. Ky tregues tregon se sa larg janë njerëzit apo grupet nga niveli zyrtar i varfërisë. Për vendet e zhvilluara të botës ky hendek matet posaçërisht për fëmijët. Ai tregon distancën midis vijës së varfërisë dhe të ardhurave mesatare të atyre që janë poshtë vijës. Hendeku i varfërisë fëminore nuk matet në Shqipëri dhe kjo është një tjetër pjesë e munguar e krahasimit midis Shqipërisë dhe vendeve të zhvilluara.

Figura 4: Hendeku i varfërisë, 2005/2008




Burimi: INSTAT, Shqipëria Trendi i Varfërisë 2002-2005-2008, 2009

Gjetjet:

- Niveli e hendekut tëvarfërisë në Shqipëri matet bazuar në ndarjen e vendit në 4 rajone të mëdha (malore, qendrore, bregdetare dhe Tirana).
- Niveli i hendekut të varfërisë është rritur në zonën malore me 0,5 përqind.

Nivelet e varfërisë për vitet 2005 dhe 2008 në zonën urbane dhe rurale paraqiten në tabelën 5.

Figura 5: Niveli i hendekut të varfërisë në zonën rurale dhe urbane, 2005 dhe 2008.




Burimi: INSTAT, Shqipëria Trendi i Varfërisë 2002-2005-2008, 2009

Gjetjet:

- Niveli e hendekut të varfërisë në të dy vitet në nivel vendi është më e lartë në zonat rurale. Në vitin 2008 zona rurale ka një normë të hendekut të varfërisë 0,7 përqind më të lartë se në zonën urbane dhe në vitin 2005 zona rurale ka një normë të hendekut të varfërisë 3 përqind më të lartë se në zonën urbane.
- Nga viti 2005 deri në vitin 2008, dallimi midis zonës rurale dhe urbane kryesisht është rritur.

Treguesi i lidhur ngushtë me hendekun e varfërisë është ashpërsia e varfërisë e cila tregon pabarazinë midis të varfërve dhe merr parasysh jo vetëm distancën nga linja e varfërisë, por edhe pabarazinë ndërmjet të varfërve. Ky tregues për vitet 2005 dhe 2008 (kur është realizuar AMNJ) dhe sipas rajoneve kryesore paraqitet në figurën 6.

Figura 6: Niveli e ashpërsisë së varfërisë, 2005/2008.



Burimi: A. Ceni, 2011

1.2 Deprivimi material: Indeksi i deprivimit të fëmijës dhe shkalla e pasurisë të familjes

Matja e të ardhurave relative, nuk është e mjaftueshme për të vlerësuar mirëqenien e fëmijëve. Fakti që një përqindje e lartë e fëmijëve jetojnë në varfëri relative nuk do të thotë se standardet aktuale të jetesës së fëmijëve janë më të ulëta (vetëm se një pjesë e madhe e fëmijëve jetojnë në familje ku të ardhurat e disponueshme janë 50 përqind e mesatares). Mirëqenia e fëmijës në vendet e pasura, në mënyrë që të arrihet në një tablo më të plotë të varfërisë fëminore, duhet të përfshihet një matje e deprivimit material aktual. Deprivimi material matet nga dy indekse:nga indeksi i deprivimit të fëmijës dhe nga shkalla e pasurisë të familjes.

1.2.1. Indeksi i deprivimit të fëmijës

Indeksi i deprivimit të fëmijës tregon se ç'përqindje e fëmijëve në çdo rajon të vendit iu mungojnë dy ose më shumë nga 14 artikujt e mëposhtëm:

- Ushqyerja tre vakte në ditë;
- Ushqyerja me të paktën një vakt në ditë, me mish, pulë ose peshk (ose e barazvlefshmja për vegjetarianët)
- Konsumimi i frutave të freskëta dhe perimeve çdo ditë;
- Përdorimi i librave të përshtatshëm për moshën e fëmijës dhe nivelin e njohurive (duke mos përfshirë tekstet shkollore);
- Mundësia për të përdorur paisje argëtuese të kohës së lirë për ambjentet e jashtme (biçikletë, patina me rrota etj);
- Veprimtari të rregullta të kohës së lirë (not, luajtje e një vegle muzikore, pjesëmarrje në organizata rinore etj);
- Lojra shtëpie (të paktën një për fëmijë, duke përfshirë edhe lodra edukative për të vegjël, blloqe ndërtimi, lojra tavoline, lojra kompjuterike etj);
- Mundësi financiare për të marrë pjesë në eskursionet dhe aktivitetet shkollore;
- Një vend i qetë me hapësirë dhe dritë të mjaftueshme për të bërë detyrat e shtëpisë;
- Mundësi komunikimi dhe informimi nëpërmjet internetit;
- Veshje të përshtatshme dhe të reja (d. m. th. jo të gjitha të përdorura);
- Dy palë këpucë të përshtatshme;
- Mundësi, herë pas here, për të ftuar miq në shtëpi, për të luajtur dhe për t'u argëtuar;
- Mundësi për të festuar raste të veçanta, si ditëlindje, ditë emri, festa fetare etj.

Treguesi i dytë i përdorur për të matur deprivimin material është bazuar në pyetësorë të shkruar të plotësuar nga kampionë përfaqësues të fëmijëve të moshës 11, 13, dhe 15 vjeç. Pjesa përkatëse e pyetësorit kërkon informacion nëpërmjet pyetjeve që vijojnë:

- A ka familja juaj një makinë, furgon ose kamion të vetin?
- Gjatë 12 muajve të fundit, sa herë keni udhëtuar larg me pushime me familjen tuaj?

- Sa kompjutera ka familja e juaj?
- A keni dhomë gjumi tuajën të gjithën për vete?

Rezultatet janë përllogaritur në shkallën e pasurisë së familjes, e cila tregon përqindjen e fëmijëve në secilin vend që jetojnë në familje me "pasuri të ulët".

Kutia 1: A kanë fëmijët të ardhura?

Sipas literaturës, shumica e niveleve të varfërisë janë bazuar në të ardhurat familjare. Por, për të llogaritur sa individë jetojnë nën nivelin e varfërisë, të ardhurat familjare duhet të kthehen në të ardhura ekuivalente personale (përfshirë "të ardhurat" për fëmijët).

Kjo nuk mund të bëhet thjesht duke pjesëtuar të ardhurat e familjes me numrin e njerëzve në familje.Mund të mos jetë e vërtetë se «dy mund të jetojnë me aq pak shpenzime sa një», por shuma që kërkohet për të ruajtur një standart të dhënë jetese nuk rritet në proporcion të drejtpërdrejtë me numrin e njerëzve në shtëpi.Kostoja e ngrohjes apo e një televizioni ose e një lidhje me internetin, për shembull, nuk do të dyfishohet, nëse janë katër njerëz dhe jo dy. Në shumë ekonomi të përmasave të tilla, blerja e ushqimeve apo materialeve të pastrimit në sasi të mëdha, është e mundëshme vetëm për familje të mëdha.

Për fat të keq nuk ka asnjë mënyrë shkencore të kthimit të të ardhurave të familjes në të ardhura individuale. Për këtë arsye duhet të përdoren metoda të sakta dhe të gatshme, nga të cilat më e zakonshme është «shkalla e modifikuar e ekuivalencës së OECD-së» sipas së cilës i pari i rritur në çdo familje llogaritet si 1,0, i rrituri i dytë si 0,5 dhe çdo fëmijë nën moshën 14 vjeç si 0,3. Atëhere totali bëhet numri i "individëve ekuivalent" me të cilët duhet të ndahen të ardhurat e familjes. Për shembull, një familje me të ardhura prej US$46,000 për dy të rritur, një 15-vjeçar dhe një fëmijë para-shkollor do të përllogaritet sikur ka ekuivalentin e 2,3 individëve dhe të ardhurat e tyre individuale të "ekuivalentuara" do të ishin US$20,000.Është kjo shifër që përdoret për të krijuar të ardhurën mesatare për vendin si tërësi (pika në të cilën saktësisht gjysma kanë më shumë dhe gjysma kanë më pak. Niveli i varfërisë relative llogaritet në përqindje të caktuar të asaj mesatareNë Bashkimin Europian, niveli llogaritet tek 60 përqinde të ardhurave mesatare të ekuivalentuara.

Numri i fëmijëve të vlerësuar që jetojnë në varfëri atëherë llogaritet si numri i individëve fëmijë që jetojnë në familje në të cilat të ardhurat e ekuivalentuara janë nën këtë vijë.

Kutia 2: Bashkimi Europian: vizioni 2020

Në qershor 2010, krerët e shteteve dhe të qeverive të 27 vendeve të Bashkimit Europian bënë thirrje për nxjerrjen nga varfëria dhe përjashtimi social të 20 milionë qytetarëve të BE-së deri në vitin 2020.

Si do të matet kjo?

Për t'u llogaritur se jeton në "varfëri apo përjashtim social", një individ duhet të jetë ose "në rrezik nga varfëria" ose "i privuar", ose "të jetojë në një familje të papunësh".Në vitin 2010, rreth 80 milionë njerëz në vendet e BE-së ranë në një apo më shumë prej këtyre tri kategorive, siç përcaktohet më poshtë:

Në rrezik:

Një person konsiderohet "në rrezik nga varfëria" nëse ai ose ajo jeton në një familje me një të ardhur të ekuivalentuar (shihni Kutia 3: A kanë fëmijët të ardhura?) nën 60përqind të mesatares së vendit.

I privuar:

Një person konsiderohet "i privuar", nëse ai ose ajo nuk është në gjendje për të përmbushur katër ose më shumë prej nëntë kritereve të mëposhtme (shënim: si lista e artikujve bazë dhe pragu i përdorur, janë të ndryshme nga matja e privimit specifike për fëmijën e përdorur në këtë Kartë Raportuese:

- mund të përballojë shpenzime të papritura,
- mund të përballojë një pushim javor larg nga shtëpia çdo vit,
- mund të paguajë vonesat e hipotekës ose qirasë, faturat e shërbimeve ose të paguajë kështet e blerjes,
- mund të përballojë një vakt me mish, pulë ose peshk çdo dy ditë,
- mund të mbajë shtëpinë të ngrohtë në mënyrë adekuate,
- mund të përballojë një makinë larëse,
- mund të përballojë një televizor me ngjyra,
- mund të përballojë një telefon,
- mund të përballojë një makinë.

Me këtë përkufizim, rreth 40 milionë qytetarë të BE-së janë aktualisht të privuar.

I papunë

Një person konsiderohet që jeton në një familje të papunësh në qoftë se asnjë i rritur nuk është në punë me pagesë ose nëse orët e shpenzuara në punë të paguar kapin shumën e më pak se 20 përqind të numrit të mundshëm të orëve në një javë nivelile pune. Me këtë përkufizim, përafërsisht 40 milion njerëz nga 250 milionë të BE-së aktualisht jetojnë në familje të papunësh.

Nga këto tri matje, treguesi "në rrezik nga varfëria" - përqindja nën 60 përqind e të ardhurave mesatare në rang vendi - konsiderohet të jetë tregues kryesor i përjashtimit social dhe është matja më e përdorur gjerësisht e varfërisë relative në Bashkimin Europian.

Një vend për fëmijët

Asnjë nga gama origjinale e 18 treguesve të përzgjedhur nga Komisioni Europian për qëllimin e monitorimit të varfërisë nuk i kushton vëmendje të veçantë nevojave të fëmijëve. Por në vitin 2008 u hodh një hap përpara drejt monitorimit të varfërisë së fëmijëve. Pas konsultimeve, një grup i treguesve specifike për jetën e fëmijëve u përfshi si një modul i veçantë në raundin e vitit 2009 të Statistikave të Bashkimit Europian mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC). Janë rezultatet e këtij sondazhi që u përpunuan për të ndërtuar indeksin me 14 artikujt e privimit të fëmijës.

"Të dhëna dytësore" dhe module të veçanta janë përfshirë në secilën anketë mbi bazën e një rotacioni katër-vjetor; "Të dhënat parësore" janë mbledhur çdo vit. Siç argumenton ky raport, disponueshmëria në kohë e të dhënave mbi varfërinë e fëmijës dhe privimin është kritike për të mbrojtur mendjet dhe trupat në rritje të fëmijëve. Prandaj të dhënat që janë specifike për fëmijët duhet të gjejnë një vend të përhershëm, vjetor në anketën e EU-SILC dhe Bashkimin Europian 10.

Kapitulli 2 Dimensioni i dytë - Shëndeti dhe siguria

Karta Raportuese Nr.11 e UNICEF (2013) vlerëson shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve nëpermjet tre komponentëve: shëndeti në lindje, shërbimet parandaluese shëndetësore dhe ddekshmëria fëminore dhe e të rinjve.

Secili prej këtyre komponenteve ka treguesit e vet, siç tregohet në tabelën 7.

Tabela 7: Vlerësimi i shëndetit dhe sigurisë

Komponentët	Treguesit
Shëndeti në lindje	Niveli i vdekshmërisë foshnjore (vdekjet nën 12 muajsh për 1000 lindje të gjalla)
	Niveli e peshës së ulët në lindje (përqind e foshnjeve të lindura nën 2500 gramë)
Shërbime parandaluese shëndetësore	Niveli e imunizimit në vend (mbulimi mesatar për fruthin, poliomielitin dhe DPT3 për fëmijët e moshës 12 deri në 23 muaj)
Vdekshmëria fëminore dhe e të rinjve	Niveli i përgjithshëm i vdëkshmërisë fëminore dhe e të rinjve (vdekje për 100 000 të moshës 1-19 vjeç)

Treguesit e përmendur më sipër në shtetin shqiptar janë si më poshtë:

Tabela 8: Vlerësimi i shëndetit dhe sigurisë për Shqipërinë

Komponentët	Treguesit
Shëndeti në lindje	Niveli i vdekshmërisë foshnjore (vdekjet nën 12 muajsh për 1000 lindje të gjalla në nivel vendi dhe për zonat / numri i vdekjeve në nivel lokal)
	Niveli i peshës së ulët në lindje (përqind e foshnjeve të lindura nën 2500 gram në nivel vendi, për zonat dhe në nivel lokal)
Shërbime parandaluese shëndetësore	Niveli e imunizimit në vend (mbulimi mesatar për fruthin, poliomielitin dhe DPT3 për fëmijë të moshës 18 deri 29 muaj)
Vdekshmëria fëminore dhe e të rinjve	Niveli i përgjithshëm i vdekshmërisë fëminore (vdekje për 1000 lindje të gjalla të moshës 0 deri në 5 në nivel vendi dhe për zonat / numri i vdekjeve në nivel lokal)

Dimensioni shëndetësor i mirëqenies së fëmijëve është bazuar në tre komponentë për të cilët janë në dispozicion të dhëna ndërkombëtarisht të krahasueshme. Komponentët janë:

- *shëndeti në lindje*- matur nga niveli e vdekshmërisë foshnjore dhe përqindja e foshnjave të lindura me peshë të ulët lindjeje (nën 2500 gramë).

- *disponueshmëria e shërbimeve parandaluese shëndetësore të fëmijëve*- siç matet nga nivelet e imunizimit në vend për fruthin, poliomielitin dhe DPT3 (vaksinat kundër difteris, tetanozit dhe kollës së mirë).
- *shëndeti dhe siguria e fëmijës*- siç matet nga niveli e vdekshmërisë fëminore nga të gjitha shkaqet.

2.1 Shëndeti në lindje – Niveli e vdekshmërisë foshnjore dhe niveli e peshës së ulët në lindje


2.1.1. Vdekshmëria foshnjore

Në të gjitha vendet e zhvilluara, nivelit e vdekshmërisë foshnjore (IMR-të) janë reduktuar në më pak se 10 vdekje foshnjore për një mijë lindje të gjalla. Prandaj ndryshimet relativisht të vogla midis vendeve nuk reflektojnë variacione në bazat e shëndetit publik të tilla si uji i sigurt dhe higjiena, por variacione në angazhimin dhe kapacitetet për të ofruar çfarëdo lloj shërbimesh që janë të nevojshme për të mbrojtur çdo nënë, çdo lindje dhe çdo foshnje në ditët dhe javët e para të jetës.

Nivelet më të larta të arsimimit zakonisht lidhen me niveli më të ulëta të vdekshmërisë në fëmijërinë e hershme, pjesërisht sepse arsimi i ekspozon femrat kundrejt informimit në lidhje me praktikat e të ushqyerit, sëmundjet e fëmijëve dhe kurimin dhe rëndësinë e lindjeve me diferencë. Në Shqipëri, diferencat në nivelit e vdekshmërisë sipas nivelit të arsimit të nënës tregojnë se fëmijët me nëna me arsim fillor ose më pak kanë më shumë të ngjarë të vdesin përpara ditëlindjes së tyre të parë ose të pestë se sa fëmijët me nëna me arsim të mesëm ose më tepër.

Gjithashtu ka një marrëdhënie ndërmjet moshës së nënës në lindje dhe vdekshmërisë në fëmijërinë e hershme. Fëmijët e lindur nga nëna të moshës 30 vjeç dhe më të mëdha në moshë kanë më tepër rrezik të vdesin se sa fëmijët që lindin nga nëna nën moshën 30 vjeç. Sidoqoftë, duhet theksuar se shifrat më të larta ndërmjet fëmijëve të femrave 30 vjeç dhe më tepër shkaktohen nga vdekshmëria më e lartë post-neonatale, në të kundërt nuk do të kishte diferenca të vdekshmërisë sipas moshës. [12] Figura 7 tregon normën e vdekshmërisë foshnjore në zonat e Shqipërisë për periudhën 10-vjeçare që i paraprin studimit.

Figura 7: Niveli e vdekshmërisë foshnjore




Burimi: INSTAT dhe ISHP, SDShSh, 2008-2009

12 INSTAT dhe ISHP, SDShSh, 2008 - 2009

Gjetjet:

- Sipas këtyre të dhënave zona malore e ka më të lartë normën e vdekshmërisë foshnjore, 38 vdekje/1000 lindje të gjalla.
- Zona bregdetare ka normën më të ulët të vdekshmërisë foshnjore dhe ajo është 13 vdekje/1000 lindje të gjalla.

Figura 8: Numri i vdekjeve, (0-1vjeç) në nivel rrethi




Burimi: Drejtoria e Shëndetit Publik e çdo qarku të vendit, 2010.

2.1.2 Shëndeti në lindje: peshë e ulët në lindje

Treguesi i dytë i përdorur për të matur shëndetin në fillim të jetës është përqindja e foshnjave që kanë lindur me peshë të ulët në lindje (nën 2500 gramë). Pesha e lindjes e një foshnjeje është përcaktuesi i vetëm më i rëndësishëm i shanseve të saj për mbijetesë dhe rritje të shëndetshme. Foshnjat me peshë të ulët në lindje kanë një rrezik më të lartë të vdekshmërisë. Ekziston gjithashtu një udhëzues për shëndetin e përgjithshëm dhe sjelljet e shëndetësore të grave shtatzëna dhe nënave, të cilat të dyja janë të rëndësishme për çdo dimension tjetër të mirëqenies së fëmijës. Pesha e ulët në lindje dihet gjithashtu që lidhet me rritje të rrezikut të kalimit nëpër një varg problemesh shëndetësore në fëmijëri dhe në jetën prej të rrituri.

Përmirësimi i shëndetit të fëmijëve, reduktimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë fëminore, si dhe arritja e Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillim janë dhjetë prioritetet më kryesore të Ministrisë së Shëndetësisë në Shqipëri. Në Shqipëri, shërbimet shëndetësore për fëmijët e moshës 0-14 vjeç janë falas dhe të integruara në të treja nivelet e kujdesit shëndetësor: primar, sekondar (spitalet rajonale) dhe terciar (spitalet e specializuara në vend). Foshnjat me një peshë të vogël në lindje kanë një rrezik më të lartë vdekshmërie. Figura 9 tregon përqindjen e lindjeve nënpeshë në rajonet e vendit për periudhën pesëvjeçare që i paraprin studimit.

Figura 9: Pesha e ulët në lindje




Burimi: INSTAT dhe ISHP, SDShSh, 2008-2009

Gjetjet:

- 3,5 përqind e foshnjeve lindin nën 2500 gramë në nivel vendi.
- Zonat me përqindjen më të lartë të foshnjeve të lindura nën 2500 gramë janë Tirana dhe zona bregdetare (4,7përqind).

Figura 10 tregon të njëjtin tregues, por për bashkitë dhe komunat e vendit

Figura 10: Pesha e ulët në lindje në nivel bashkie/komune



Burimi: Drejtoria e Shëndetit Publik e secilit qark, 2010

Gjetjet:


- Informacioni i mësipërm tregon foshnjat e lindura nën peshë në nivel lokal (bashki/komunë).
- Niveli më i lartë i foshnjeve të lindura nën 2500 gramë është në Bashkinë Durrës, Komunat Gjepalaj dhe Iballë, përkatësisht 35përqind, 33,6përqind dhe 14,9përqind e foshnjeve të lindura nën normë.
- Niveli më i ulët i foshnjeve të lindura nën 2500 gramë është në Portëz me 0,01përqind.

2.2 Shërbimet parandaluese shëndetësore

2.2.1. Niveli i përgjithshëm i imunizimit

Komponenti i dytë i zgjedhur për të vlerësuar shëndetin e fëmijëve është disponueshmëria dhe efektiviteti i një vendi për shërbimet parandaluese shëndetësore të fëmijëve. Kjo është matur nga niveli e imunizimit (mbulimi mesatar i vaksinimit për fruthin, poliomelitin dhe DPT3). Imunizimi kundër sëmundjeve që parandalohen me vaksinë është vendimtar për reduktimin e vdekshmërisë foshnjore dhe fëminore. Imunizimi i fëmijëve me vaksinat bazë të fëmijëve është një nga ndërhyrjet shëndetësore me kosto-efektive të disponueshme. Nivelit e zakonshme të imunizimit në vendet e zhvilluara janë mbajtur përgjithësisht në nivele të larta, mesatarisht rreth 95 përqind. Figura 11 paraqet nivelin e imunizimit në shkallë vendi dhe sipas rajoneve.

Figura 11: Niveli i imunizimit



Burimi: INSTAT dhe ISHP, SDShSh, 2008-2009

Gjetjet:

- Tirana dhe zona malore ka mbulim të plotë me vaksinimin, që do të thotë se100 përqinde popullsisë ka bërë të gjitha vaksinimet bazë.
- Niveli i imunizimit për zonën qëndrore dhe zonën bregdetare është nën normën standarde të imunizimit të vendeve të zhvilluara.
- Niveli më i ulët i imunizimit është në Tiranë për imunizimin e DPT3 (70,2 përqind), 24,8 përqind nën normën e imunizimit standard të vendeve të zhvilluara.

2.3 Vdekshmëria fëminore

2.3.1 Niveli i vdekshmërisë fëminore, mosha 1-19 vjeç


Komponenti i tretë që përdoret për të ndërtuar një tablo të përgjithshme të shëndetit të fëmijës është niveli e vdekshmërisë ndërmjet fëmijëve. Sipas Kartës Raportuese 11, UNICEF (2013), niveli e vdekjes ndërmjet fëmijëve dhe të rinjve llogaritet për grupmoshën 1-19 vjeç. Vdekjet në këtë grupmoshë janë të rralla në ekonomitë e përparuara dhe shkaqet shkojnë përtej sëmundjes dhe efikasitetit të shërbimeve shëndetësore duke përfshirë vdekje nga vetëvrasja, vrasja, plagosjet në trafik, mbytjet, rëniet dhe zjarret.

Në Shqipëri nuk ka asnjë tregues që mat normën e vdekshmërisë për të rinjtë deri në 19 vjeç. Për këtë arsye kjo pjesë analizohet duke u bazuar nëtreguesin: Shkalla e vdekshmërisë fëminore 0 deri në 5 vjeç.

Në lidhje me kujdesin që përfitojnë fëmijët që vijnë nga familje të varfra, raportohet se familjet me nivel të ulët të shpenzimeve shpenzojnë sa ⅓ e shpenzimeve mesatare për kujdesin shëndetsor të fëmijëve (IKU & QKSS 2011), ndërsa në të njëjtin raport tregohet se gjysma e fëmijëve me sëmundje kronike i përkasin po këtyre familjeve (me nivel të ulët

të shpenzimeve) (IKU & QKSS 2011). Figura 12 tregon normën e vdekshmërisë fëminore të zonave të Shqipërisë për periudhën 10-vjeçare që i paraprin studimit.

Figura 12: Niveli i vdekshmërisë fëminore, (vdekje/1,000 lindje të gjalla)



Burimi: INSTAT dhe ISHP, SDShSh, 2008-2009

Gjetjet:

- Sipas këtyre të dhënave zona malore ka normën më të lartë të vdekshmërisë fëminore, 42 vdekje/1000 lindje të gjalla.
- Zona bregdetare ka normën më të ulët të vdekshmërisë foshnjore dhe ajo është 16 vdekje/1000 lindje të gjalla.
- Të njëjtat diferenca u konstatuan. Zona malore kishte normën më të lartë të vdekjeve dhe zona bregdetare kishte normën më të ulët të vdekjeve.

Të marra së bashku, të tre komponentët e përcaktuar më lart sigurojnë një udhëzues të përafërt me dimensionin e shëndetit të mirëqenies së fëmijëve. Në mënyrë ideale, një vështrim i tillë do të kishte përfshirë gjithashtu disa tregues të shëndetit mendor dhe emocional të fëmijëve dhe të mbizotërimit të abuzimit me fëmijët dhe neglizhimit. Por çështje të tilla janë të vështira për t'u përcaktuar dhe matur madje edhe brenda një vendi të veçantë. Në nivel ndërkombëtar nuk ka të dhëna të krahasueshme të disponueshme.

Kapitulli 3 Dimensioni i tretë - Mirëqenia arsimore

Sipas Kartës Raportuese 11, UNICEF (2013), mirëqenia arsimore e fëmijëve vlerësohet nga dy komponentë: pjesëmarrja dhe arritja.

Të marra së bashku ato ofrojnë një udhëzues të përafërt për sasinë dhe cilësinë e arsimit. Secili prej këtyre komponenteve ka treguesit e vet, siç tregohet në tabelën 9.

Tabela 9: Vlerësimi mirëqenies arsimore sipas standartit ndërkombëtar

Komponentët	Treguesit
Pjesëmarrja	Shkalla e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor (përqind e atyre mes moshës 4 vjeç dhe fillimi i arsimit të detyrueshëm, i atyre të cilëve janë regjistruar në arsimin parashkollor);
	Niveli i pjesëmarrjes në arsimin e mëtejshëm (përqind e atyre të moshës 15 deri në 19 të regjistruar në arsimin e mëtejshëm);
	Niveli NEET (përqind e moshës 15 deri 19 që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim);
Arritja	Rezultatet mesatare të PISA-as në lexim, matematikë dhe kulturë shkencore;

Treguesit e sipër përmendur në shtetin shqiptar janë si në tabelën 10:

Tabela 10: Vlerësimi i mirëqenies arsimore për Shqipërinë

Komponentët	Treguesit
Pjesëmarrja	Niveli i pjesëmarrjes në arsimin parashkollor (përqind e atyre mes moshës 3-6 vjeç të cilët janë regjistruar në arsimin parashkollor);
	Niveli i pjesëmarrjes në arsimin e mëtejshëm (përqind e atyre të moshës 15 deri 18 të regjistruar në arsimin e mëtejshëm);
	Niveli NEET (përqind e moshës 15 deri 17 që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim);
Arritja	Rezultatet mesatare të PISA-as në lexim, matematikë dhe kulturë shkencore

3.1 Pjesëmarrja

Komponenti i parë, pjesëmarrja, është vlerësuar nga tre tregues: pjesëmarrja në arsim në fëmijërinë e hershme, pjesëmarrja në arsimin e mëtejshëm, Përqindja e të rinjve, të moshës 15 deri 18, të cilët nuk marrin pjesë në arsim, trajnim ose punësim.


3.1.1 Pjesëmarrja: Niveli i pjesëmarrjes në arsimin parashkollor - Arsimi në fëmijërinë e hershme

Kohët e fundit është pranuar gjerësisht se themelet e suksesit arsimor hidhen përpara se të fillojë arsimi formal. Në përgjigje të këtyre presioneve dhe të të tjerave, të gjitha qeveritë në vendet e zhvilluara kanë investuar në një shkallë më të madhe ose më të vogël në arsimin parashkollor falas ose të subvencionuar.

Për disa dekada, kërkimet në fushën arsimore vazhdimisht kanë vendosur gishtin mbi faktin se themelet e të mësuarit hidhen në muajt dhe vitet e para të jetës dhe se përpjekja për t'i dhënë fëmijës fillimin më të mirë të mundshëm duhet të fillojë shumë vite përpara nisjes së arsimit zyrtar. Kjo kërkesë në rritje e kombinuar me ndryshimet e tjera, si rritja e shpejtë e pjesëmarrjes së grave në forcën e punës dhe rritja e theksuar e numrit të familjeve me një prind, e ka bërë kujdesin për fëmijën një nga çështjet më të mëdha me të cilat po përballen familjet dhe qeveritë.

Treguesi i parë për t'u analizuar është pjesëmarrja në arsim në fëmijërinë e hershme. Figura 13 paraqet pjesëmarrjen në arsim në fëmijërinë e hershme sipas qarqeve.

Figura 13: Pjesëmarrja në arsim në fëmijërinë e hershme (qark), 2012




Burimi: Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (Korrik 2013)

Gjetjet:

- Shihet qartë se shkalla e regjistrimit në arsimin parashkollor në të gjitha qarqet e Shqipërisë është nën 50përqind.
- Përqindja më e lartë e normës së regjistrimit është në qarkun e Korçës me 39 përqind.
- Përqindja më e ulët e normës së regjistrimit është në Shkodër me 21përqind.

Figura 14 tregon përqindjen e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç të cilët janë regjistruar në arsimin parashkollor në disa rrethe të Shqipërisë.

Figura 14: Pjesëmarrja në arsim në fëmijërinë e hershme (rreth), 2012.




Burimi: Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (Korrik 2013)

Gjetjet:

- Në nivel rrethi situata nuk ndryshon aq shumë krahasuar me nivelin e qarkut, dhe asnjë prej rretheve nuk kalon vlerën 50 përqind të regjistrimit
- Vlera më e lartë është në rrethin e Pogradecit 47përqind, ndjekur nga rrethi i Devollit 41përqind dhe rrethi i Tepelenës 40 përqind.
- Shkalla më e ulët e regjistrimit është në rrethin e Shkodrës, 19 përqind.

Figura 15 tregon shkallën e regjistrimit në arsimin parashkollor për bashkitë/komunat të cilat kanë përqindjen më të ulët dhe më të lartë të normës së regjistrimit.

Figura 15: Pjesëmarrja në arsim në fëmijërinë e hershme (bashki/komunë), 2010



Burimi: Drejtoria Arsimore Rajonale (2011)

Gjetjet:


- Bashkitë/komunat që kanë normën e regjistrimit mbi 70 përqind janë: Çorovoda (70përqind), Bashkia Vlorë (71 përqind), Bytyçi (74 përqind), Bashkia Librazhd (78 përqind), Aranitas (84 përqind), Tunjë (90 përqind) dhe Bashkia Bajram Curri (91përqind).
- Bashkitë/komunat që e kanë normën e regjistrimit më poshtë se 15 përqind janë: Komuna Velipoje (4 përqind), Kelmend (7 përqind), Stravaj (9 përqind), Cudhi, Dhivër, Arras (10 përqind), Postribë (11 përqind), Gjerbes , Mesopotan, Orikum (12 përqind), Rashbull (13 përqind), Himarë (14 përqind), Lekbibaj dhe Markat (15 përqind).

3.1.2 Edukimi i mëtejshëm

Tregues tjetër i arsimimit është niveli e pjesëmarrjes në arsimin e mëtejshëm e cila tregon përqindjen e të rinjve të moshës 15 deri 18 vjeç të cilët janë regjistruar në shkolla dhe kolegje. Në Shqipëri, ky tregues përfshin grupmoshën 15-18 vjeç. Pjesëmarrja në arsimin e mëtejshëm pasqyron "mirëqenien arsimore" sepse dëshmon kalimin e suksesshëm nëpër vitet e shkollimit të detyrueshëm. Sigurisht që ajo është gjithashtu e shoqëruar me një gamë të gjerë të mundësive në fillim të jetës prej të rrituri.

Figura 16 tregon përqindjen e fëmijëve të moshës 15-18 vjeç të cilët janë regjistruar në arsimin e mëtejshëm në qarqet e Shqipërisë.

Figura 16: Niveli e pjesëmarjes në arsimin e mëtejshëm (qark), 2010




Burimi: Drejtoria Arsimore Rajonale (2011

Gjetjet:

- Si në normën e regjistrimit në arsimin parashkollor, e njëjta situatë është edhe në arsimin e mëtejshëm. Shkalla e regjistrimit në arsimin e mëtejshëm nuk e kalon 50 përqind.
- Përqindja më e lartë e normës së regjistrimit është në qarkun e Kukësit me 49 përqind.
- Përqindja më e ulët e normës së regjistrimit është në qarkun e Beratit me 30 përqind.

Figura 17 tregon përqindjen e fëmijëve të moshës 15-18 vjeç të cilët janë regjistruar në arsimin e mëtejshëm në disa rrethe të Shqipërisë.

Figura 17: Niveli e pjesmarjes në arsimin e mesëm (rreth), 2010




Burimi: Drejtoria Arsimore Rajonale (2011)

Gjetjet:

- Në nivel rrethi situata nuk ndryshon aq shumë krahasuar me nivelin e qarkut, por disa prej rretheve kanë një normë regjistrimi 2-3 pikë në përqindje më të lartë se 50 përqind.
- Vlera më e lartë është në rrethin e Tropojës dhe në rrethin e Matit dhe të dy kanë një normë regjistrimi prej 53 përqind
- Shkalla më e ulët e regjistrimit është në rrethin e Delvinës , 22 përqind.

Figura 18 tregon normën e regjistrimit në arsimin e mëtejshëm për bashkitë/komunat të cilat kanë përqindjen më të ulët dhe më të lartë të normës së regjistrimit

Figura 18: Niveli e pjesmarjes në arsimin e mesëm (bashki/komunë), 2010



Burimi: Drejtoria Arsimore Rajonale (2011))

Niveli i ulët i frekuentimit të shkollës, është pashmangshmërisht e lidhur dhe me nivelin ekonomik të familjes. 65 përqind e fëmijëve që nuk frekuentojnë rregullisht shkollën i përkasin familjeve të niveleve më të ulta të shpenzimeve (IKU & QKSS 2011);

Gjetjet:

- Bashkitë/komunat që kanë normë regjistrimi mbi 90 përqind janë: Bashkia Fier (91 përqind), Koplik (93 përqind), Bilisht (95 përqind), Burrel (96 përqind), Bajram Curri (96 përqind), Çorovodë (97 përqind) dhe Roskovec (100 përqind).
- Bashkitë/komunat që kanë normë regjistrimi më të ulët se 15 përqind janë: Fushë Bulqizë (1 përqind), Ostren (3 përqind), Lurë (4 përqind), Luzni (5 përqind), Dërmenas dhe Kala e Dodës (7 përqind), Zall Dardhë dhe Nikël (8 përqind), Rashbull (9 përqind), Perondi dhe Lukovë (11 përqind), Kthellë dhe Armen (12 përqind), Himarë dhe Levan (13 përqind), Velabisht (14 përqind).
- Në disa komuna fëmijët ndjekin shkollat e mesme në bashkinë më të afërt dhe jo brenda territorit të tyre. Kjo lëvizje nuk është regjistruar në shkollat nga ku ata janë transferuar, kështu që kjo dukuri ul normën e regjistrimit në arsimin e mëtejshëm të komunave nga ku ata janë transferuar.

3.1.3 Niveli NEET

Treguesi i tretë i mirëqenies arsimore e shikon pjesëmarrjen nga një perspektive tjetër - përqindja e të rinjve (të moshës 15 deri 19), të cilët nuk marrin pjesë as në arsim, as në punësim apo trajnim (e ashtuquajtura niveli "NEET" e cila në anglisht është "Not engaged in Education, Employment or Training"). Në të gjitha vendet, nivelit NEET ndikohen nga

kushtet ekonomike dhe mundësitë e punësimit, si edhe nga efektiviteti i sistemeve arsimore në përgatitjen e të rinjve për kalimin në punë. Po njësoj, një normë NEET e lartë përfaqëson një kërcënim për mirëqenien aktuale dhe të ardhme të të rinjve, një dekurajim për ata ende në sistemin e arsimit dhe një humbje të investimeve arsimore dhe burimeve njerëzore. Hulumtimi në vende të ndryshme ka treguar gjithashtu lidhjen ndërmjet gjendjes së NEET-it dhe problemeve të shëndetit mendor, abuzimit me drogën, përfshirjes në krim dhe papunësisë afatgjatë e varësisë nga mirëqenia.

Në Shqipëri ky tregues matet në nivel vendi. Sipas studimit A. Ceni (2011), niveli NEET matet për grupmoshën 15-17 vjeç. Përqindja e fëmijëve 15-17 vjeç të cilët nuk marrin pjesë qoftë në arsim, punësim apo trajnim është 21,3 përqind. Kjo do të thotë se 21,3 përqind e kësaj grupmoshe nuk është aktive në shoqëri.


3.2 Arritjet

3. 2. 1 Rezultatet mesatare të PISA-s në lexim, matematikë dhe shkencë

Komponenti i dytë i mirëqenies arsimore është cilësia e arsimimit. Ky element kyç i mirëqenies së fëmijës është natyrisht i vështirë për t'u përcaktuar dhe matur mbi një bazë të krahasueshme ndërkombëtare. Në mënyrë ideale, koncepti i «cilësisë» në arsim do të përfshinte një gamë të gjerë të faktorëve të tillë si zhvillimi i të kuptuarit social dhe formimi i vlerave (duke përfshirë arsimin për qytetari), si edhe mundësinë për të zhvilluar aftësitë dhe potencialet e ndryshme të të rinjve. Aktualisht, matja e vetme praktike e cilësisë në arsim ofrohet nga *Programi* i OECD-sëpër *Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (PISA)*, i cili mat aftësitë e nxënësve në tre kompetenca themelore - lexim, matematikë dhe shkencë. Të përsëritur çdo tre vjet, testet administrohen me kampionë përfaqësues me 15-vjeçarë dhe kanë për qëllim të masin njohuritë dhe aftësitë në lidhje me kërkesat e menaxhimit të jetëve dhe karrierave në botën moderne.

Figura 19 tregon rezultatet e PISA-s për Shqipërinë në tre lëndë themelore - matematikë, lexim dhe shkencë si dhe rezultatin mesatar të PISA-s për këto tre lëndë

Figura 19: Arritjet arsimore deri 15 vjeç



Burimi: OECD, 2010

Gjetjet:

- Sipas kësaj figure, fëmijët shqiptarë 15 vjeçarë kanë një aftësi mesatare në matematikë, shkencë dhe lexim prej 384,3 pikësh dhe ajo është statistikisht dukshëmnënmesataren e OECD-së, e cila është 496,7 pikë.
- Performanca e tyre më e mirë është në shkencë (391 pikë) dhe performanca e tyre më e keqe është në matematikë (377 pikë), megjithatë të gjitha aftësitë janë nën mesataren e OECD-së.

Kapitulli 4 Dimensioni i katërt: Sjelljet dhe Rreziqet

Sipas Kartës Raportuese 11, UNICEF (2013), sjelljet e fëmijëve dhe rreziqet janë vlerësuar nga tre komponentë: ushqimi dhe ushtrimi, rreziqet dhe sjelljet dhe ekspozimi ndaj dhunës.

Secili prej këtyre komponenteve ka treguesit e vet, siç tregohet në tabelën 11:

Tabela 11: Vlerësimi i sjelljeve dhe rreziqeve

Komponentët	Treguesit
Ushqimi dhe ushtrimi	Përqindja e fëmijëve mbipeshë.
	Përqindja e fëmijëve që konsumojnë vaktin e mëngjesit çdo ditë.
	Përqindja e fëmijëve që konsumojnë frutaçdo ditë.
	Përqindja e fëmijëve që merren me ushtrime e sport.
Sjellje të rrezikshme	Niveli e fertilitetit tek adoleshentët.
	Pirja duhanit.
	Konsumimi i alkolit.
	Përdorimi i kanabisit.
Ekspozimi ndaj dhunës	Ushtrimi i dhunës.
	Ushtrimi i dhunës ndërmjet fëmijëve

Të gjithë këta tregues shërbejnë për të pasqyruar situatën në Shqipëri.

Dimensioni i katërt i mirëqenies së fëmijës duke u përfshirë në tabelën e lidhjes së përgjithshme të mirëqënies së fëmijëve është më i vështirë për t'u përcaktuar se mirëqenia materiale ose shëndeti apo arsimi. Ky dimension 'Sjelljet dhe rreziqet" përfshin dhe analizon një gamë të gjerë të zakoneve dhe sjelljeve të të miturve, të cilat ndikojnë në sjelljet sociale dhe kulturore të fëmijëve sot duke u bërë një normë e shoqërisë në një të ardhme të afërt.

4.1 Jetesa e shëndetshme

Jetesa e shëndetshme vlerësohet nëpërmjet tre kompnentëve të veçantë. Komponenti i parë ka të bëjë me përqindjen e fëmijëve të cilët kanë formuar zakone të shëndetshme, të mirë-informuara të të ngrënit dhe ushtruarit. Kjo matet nga katër tregues individualë:


- Përqindja e atyre që janë mbipeshë (e matur me indeksin e masës trupore të përllogaritur nga vetë-raportimi i gjatësisë dhe peshës);
- Përqindja e fëmijëve në secilin vend të cilët raportojnë ngrënien e mëngjesit;
- Përqindja e atyre që raportojnë ngrënien e frutave;
- Përqindja e atyre që raportojnë angazhimin në ushtrime fizike për të paktën një orë çdo ditë.

Të gjithë këta tregues, ndonëse të rëndësive të ndryshme, janë të lidhur me shëndetin afatgjatë dhe mirëqenien. Të ushtruarit e rregullt, për shembull, është i lidhur jo vetëm me shëndetin fizik dhe mendor, por me parandalimin dhe/ose trajtimin e problemeve të veçanta të tilla si astma, mbipesha, ankthi dhe depresioni. Modelet e ngrënies se pashëndetshme në vitet e hershme kanë treguar gjithashtu se rrisin rrezikun e problemeve shëndetësore në jetën e mëvonshme, duke përfshirë diabetin, sëmundje të zemrës dhe kancerin.

4.1.1 Fëmijët mbi peshë

Figura 20 tregon përqindjen e fëmijëve mbi peshë.

Figura 20: Përqindja e fëmijëve mbipeshë (BMI[13])



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik, 2013

Gjetjet:

- Përqindja e fëmijëve mbipeshë zvogëlohet me rritjen e moshës.
- Përqindja e mbipeshës tek fëmijët 11 vjeçarë është 6,3 përqind, tek fëmijët 13 vjeçarë është 3,4 përqind dhe tek fëmijët 15 vjeçarë është1,6 përqind.
- Sipas të njëjtës anketë, përqindja e mbipeshës tek fëmijët e kësaj grupmoshe është më e lartë tek meshkujt (5,3 përqind)se tek femra (2,4 përqind).
- Fenomeni është më problematik në zonat urbane (4,2 përqind)se sa në zonat rurale (3,3 përqind)

4.1.2 Ngrënia e mëngjesit


Ashtu si disa prej matjeve në këtë raport, zakonet e të ngrënit në fëmijëri dhe adoleshencë janë tregues të mirëqenies aktuale dhe të ardhme. Ata që nuk hanë shëndetshëm gjatë viteve të hershme të jetës kanë më shumë mundësi të vazhdojnë modelin në moshë të

13 Indeksi i Masës Trupore për mbipeshë: BMI> 2 deviacionet standarde mbi mesataren e kurbave të rritjes standarde të OBSH-së.

rritur dhe të jenë të rrezikuar edhe gjatë rritjes nga problemet e shëndetit duke përfshirë diabetin, sëmundjet e zemrës dhe kancerin (UNICEF 2007).

Figura 21 tregon numrin e ditëve të javës, gjatë të cilave fëmijët hanë mëngjes.

Figura 21: Përqindja e fëmijëve që hanë mëngjes, 2013



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik, 2013


Gjetjet:

- 44,4 përqind e fëmijëve hanë mëngjes. Përqindja e fëmijëve që hanë mëngjes rregullisht është më e lartë tek djemtë (47,2 përqind) se sa tek vajzat (43,8 përqind).
- Përqindja e fëmijëve të cilët raportojnë që nuk hanë kurrë mëngjes është 26,3 përqind dhe kjo vlerë është më e lartë te vajzat (29,6 përqind) se sa te djemtë (23,8 përqind).

4.1.3 Konsumimi i frutave

Figura 22 paraqet përqindjen e fëmijëve që konsumojnë fruta.

Figura 22: Përqindja e fëmijëve që konsumojnë fruta , 2013



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik, 2013


Gjetjet:

- 29,9 përqind e fëmijëve të moshës 11, 13 dhe 15 vjeç, raportojnë se konsumojnë fruta më shumë se një herë në ditë dhe 2,1 përqind e fëmijëve raportojnë se nuk konsumojnë kurrë fruta.
- Fëmijët femra kanë një frekuencë më të lartë të konsumit të frutave më shumë se një herë në ditë.
- Përqindja e fëmijëve që konsumojnë fruta më shumë se një herë në ditë zvogëlohet me rritjen e moshës. Kjo do të thotë se përqindja e fëmijëve që hanë fruta më shumë se një herë në ditë është më e lartë tek fëmijët 11 vjeçarë se tek fëmijët 15 vjeçarë.

4.1.4 Ushtrimet fizike

Figura 23 tregon përqindjen e fëmijëve shqiptar që kryejnë aktivitet fizik.

Figura 23: Përqindja e fëmijëve që kryejnë aktivitet fizik



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik, 2013

Gjetjet:

- Përqindja e fëmijëve që raportojnë se kanë aktivitet të përditshëm fizik është më e lartë te fëmijët 11 vjeçarë (30,7përqind).
- Përqindja e fëmijëve të cilët nuk bëjnë kurrë ushtrime fizike është më e lartë te fëmijët 15 vjeçarë (4,1përqind).
- Ky studim nuk tregon ndonjë informacion gjinor, kush ushtrohen më shumë, vajzat apo djemtë.

4.2 Sjellje të rrezikshme

Komponenti i dytë i konsideruar "sjellje dhe rreziqe" është dominimi i një grupi të dytë të sjelljeve që paraqesin rreziqe të menjëhershme për fëmijët, si dhe kërcënime serioze për mirëqenien afatgjatë. Brenda kufizimeve të të dhënave të disponueshme, janë zgjedhur katër tregues të vlerësimit të rrezikshmërisë:

- Niveli e fertilitetit tek adoleshentët (numri vjetor i lindjeve për 1000 vajza të moshës 15 deri 19);
- Niveli e duhanpirjes;
- Niveli e abuzimit me alkolin;
- Niveli e përdorimit të kanabisit;

Sjlljet dhe rreziqet e diskutuara në këtë seksion nuk janë paraqitur si një katalog i problemeve sociale, por si një përpjekje për të matur një dimension të rëndësishëm dhe të pakapshëm të mirëqenies së fëmijës. Mund të ketë shumë arsye përse fëmijët dhe të rinjtë abuzojnë me drogën ose bëjnë një stil jetese të pashëndetshme, ose mbeten shtatzënë në një moshë shumë të hershme, por këto arsye shpesh pasqyrojnë rrethanat, presionet dhe vetë perceptimet që minojnë mirëqenien. Në mënyra që nuk janë kuptuar plotësisht, ato tregojnë problemet dhe presionet që përballojnë një pjesë e konsiderueshme e të rinjve në vendet në shqyrtim. Rezultatet e treguara në tabelat e mëposhtme, pasqyrojnë në një farë shkalle papërgatitjen e tyre dhe paaftësinë për t'u përballur me një presion të tillë (UNICEF,2013).

4.2.1 Niveli e fertilitetit tek adoloshentët

Sipas anketimit ADHS 2008-2009, niveli e fertilitetit te adoleshentët për Shqipërinë është17 lindje/1000 vajza të moshës 15 deri 19 vjeç. Lindja në një moshë shumë të re vë në rrezik mirëqenien e nënës dhe të fëmijës. Përveç kësaj ekziston rreziku më i madh i braktisjes së shkollës, papunësisë, varfërisë dhe varësisë nga mirëqenia – duke ndihmuar kështu në vazhdimësinë e disavantazhit nga njëri brez tek tjetri. Fëmija është gjithashtu në rrezik më të madh - të varfërisë, të shëndetit të dobët dhe rezultateve të ulëta në shkollë. Drejtimi i shkakësisë në këto marrëdhënie nuk është domosdoshmërisht i prerë qartë. Nënat adoleshente priren të vijnë nga mjedise të varfëra, të mos kenë rezultate të mira në shkollë dhe të kenë perspektiva më të pakta të karrierës. Të pasurit e një fëmije mund t'i bëjë të gjitha këto probleme edhe më keq, por mospasja e një fëmije nuk do largojë ato. Megjithatë, të pasurit e një fëmijë në moshë tepër të re është një tregues më tepër i asaj që mund të ketë shkuar keq në jetën e një të reje përpara se ajo të mbetej shtatëzanë. Dhe është për këtë arsye që nivelit e lindjes tek adoleshentët konsiderohen gjerësisht si një tregues veçanërisht zbulues i shumë aspekteve të mirëqenies së fëmijëve që janë të vështirë për të kapur në të tjera forma.

4.2.2 Duhanpirja

Sipas studimit të Institutit të Shëndetit Publik "Vlerësimi i sjelljeve të shëndetshme te fëmijët e moshës shkollore", përqindja e fëmijëve (11, 13 dhe 15 vjeç) të cilët raportojnë pirjen e duhanit është*4,6 përqind.* Kjo përqindje është më e lartë te djemtë *(7,5 përqind)* se sa te vajzat *(2,1 përqind).*

4.2.3 Alkooli

Sipas së njëjtit studim përqindja e fëmijëve që raportojnë konsumin e alkoolit është0,8 përqind. Kjo frekuencë rritet me rritjen e moshës. Kjo do të thotë se kjo frekuencë është më e lartë te fëmijët 15 vjeçarë dhe ajo është më problematike te fëmijët që jetojnë në zonat urbane(ISHP, 2013).

4.2.4 Kanabis

E njëjta situatë raportohet edhe për konsumin e kanabisit. Tek fëmijët 15 vjeçarë niveli e konsumit të kanabisit është*4,6 përqind* dhe kjo është më e lartë te djemtë se sa te vajzat (ISHP, 2013).

4. 3 Ekspozimi ndaj dhunës

Komponenti i fundit i dimensionit "sjellje dhe rreziqe" i mirëqenies së fëmijës është shkalla në të cilën fëmijët dhe të rinjtë përjetojnë dhunë në jetën e tyre. Duke pasur parasysh rreziqet e njohura të rritjes në një mjedis të dhunshëm - nga vuajtjet dhe plagosjet e menjëhershme te problemet afatgjata të depresionit, ankthit, problemet e sjelljes dhe tendencës për të përdorur dhunë - është për të ardhur keq që janë pak të dhëna në dispozicion për të krahasuar ekspozimin e fëmijëve ndaj dhunës qoftë si viktima apo si dëshmitarë.

Gjatë vitit 2012 në Shqipëri është prezantuar programi që trajton ndëshkimin fizik dhe dhunën psikologjike në shkolla[14].

Agresioni dhe dhuna në të gjitha format e saj - tallja, zënkat, abuzimi - hijëzojnë jetën e shumë të rinjve, duke e kthyer pjesën e jetës që të rriturit duan ta mendojnë si të lumtur dhe pa brenga në një kohë ankthi dhe mjerimi. Në veçanti, ekspozimi ndaj dhunës në shtëpi - qoftë direkt përmes abuzimit me fëmijën dhe në indirekt përmes të qenit dëshmitarë të agresionit dhe dhunës mes të rriturve - mund të jetë një shkak i zgjatjes së ankthit dhe të dëmtimit të fëmijëve të të gjitha moshave. Për fat të keq, ekspozimi ndaj dhunës është i vështirë për t'u përcaktuar dhe treguesit në dispozicion janë të pamjaftueshëm për detyrën e reflekimit qoftë të mjerimit aktual apo të pasojave në të ardhmen (UNICEF, 2007)

4.3.1 Zënkat

Sipas studimit *"Reformimi i Ndihmës Ekonomik*e" nga mbijetesa tek investimi në uljen e varfërisë " përqindja e fëmijëve të përfshirë në zënka në Shqipëri është 12,5 përqind.

4.3.2 Tallja

Problemi tjetër në mirëqenien emocionale të fëmijëve është *tallja*. Të tallurit mund ta bëjë të mjerë jetën e një fëmije për javë, muaj apo edhe vite. Ai mund të kontribuojë gjithashtu në probleme emocionale dhe të sjelljes, duke përfshirë ankthin dhe depresionin, performancën e dobët në shkollë dhe mosvijueshmëri në rritje e mungesa pa arsye. Por monitorimi i talljes në jetën e fëmijëve është bërë më i vështirë nga fakti se ai është i vështirë për t'u përcaktuar. Sipas studimit *"Reformimi i ndihmës ekonomike: nga mbijetesa tek investimi në uljen e varfërisë",* përqindja e fëmijëve të cilët janë tallur nga fëmijët e tjerë në Shqipëri është 13,8 përqind.

14 "Raporti i Progresit i vitit 2012 për Shqipërinë" Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Europian dhe Këshillin; Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2012-2013; Bruksel, 10. 10. 2012; faqe 19.

Kapitulli 5 Dimensioni i pestë: Strehimi dhe mjedisi

Sipas Kartës Raportuese 11, UNICEF (2013), mirëqenia mjedisore e fëmijëve vlerësohet nga dy komponentë: strehimi, që matet nga mbipopullimi dhe problemet e raportuara me strehimin, siguria mjedisore, që matet nga ekspozimi i fëmijëve ndaj krimit dhe ndotjes.

Secili prej këtyre komponentëve ka treguesit e vet, siç tregohet në tabelën 12.

Tabela 12: Vlerësimi i mirëqenies mjedisore

Komponentët	Treguesit
Strehimi	Dhoma për person
	Përqindja e familjeve me fëmijë që raportojnë më shumë se një problem me strehimin
Siguria mjedisore	Niveli i vrasjeve (numri vjetor i vrasjeve për 100 000)
	Ndotja e ajrit (PM10 vjetore [µg/m3])

Nëse ne e përdorim këtë tabelë për të marrë një pasqyrë mbi situatën shqiptare në lidhje me këta tregues na rezulton tabela 13

Tabela 13: Vlerësimi i mirëqenies mjedisore për Shqipërinë

Komponentët	Treguesit
Strehimi	Dhomat për person
	Përqindja e fëmijëve të cilët raportojnë se kanë së paku 2 probleme në shtëpitë e tyre si dritare, dyer ose dysheme të prishura, lagështi ose mungesë të një tualeti brenda shtëpisë.
Siguria mjedisore	Vrasje me dashje (për 100 000 njerëz)
	Emetimet e CO2 (ton metrikë për frymë)

5.1 Strehimi


Shtetet Palë, në përputhje me kushtet në vend dhe mundësitë e tyre, duhet të marrin masat e duhura për të ndihmuar prindërit dhe personat e tjerë përgjegjës për fëmijën, për të zbatuar këtë të drejtë dhe duhet në rast nevoje të ofrojnë ndihmë materiale dhe programe mbështetëse, sidomos lidhur me ushqimin, veshmbathjen dhe strehimin. (Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës, Neni 4 / Pika 3)

5.1.1 Dhoma për person, mbipopullimi

Në shumë familje, epoka moderne sheh një zbraztirë në jetët dhe shtëpitë e fëmijëve. Në vend të pasjes së katër ose pesë motrave dhe vëllezërve, fëmija i sotëm më zakonisht ka një ose asnjë. Në të njëjtën kohë, nivelit e rritjes së divorcit dhe ndarjes, ndryshimet në strukturën e familjes, si dhe rritja e përkujdesit të fëmijëve jashtë shtëpisë do të thotë se shumë fëmijë jetojnë në shtëpi që janë dukshëm më pak të mbushura me njerëz se sa në të kaluarën. Megjithatë, aty ku ekziston mbipopullimi është një faktor i rëndësishëm në mirëqenien e fëmijëve. Përveç humbjes së mundësisë për privatësi dhe për një kohë të qetë dhe studim, mbipopullimi ka qenë gjithashtu i lidhur me efekte negative në sjelljet prindërore dhe në zhvillimin kognitiv e emocional të fëmijëve, duke përfshirë rrezikun në rritje të stresit dhe vështirësive të sjelljes. Variabli më i rëndësishëm duket të jetë dhoma-për-person.

Figura 24 tregon hapësirën e banimit në m^2 për frymë në familjet me fëmijë.

Figura 24: Hapësira e banimit në m^2 për frymë në familjet me fëmijë




Burimi: Qëndra Kombëtare për Studime Sociale dhe Instituti i Kërkimeve Urbane, 2012

Gjetjet:

- Më shumë se gjysma e familjeve shqiptare (54 përqind) kanë një hapësirë banimi prej11-20 m2 për person.
- Vetëm 3 përqind e familjeve me fëmijë kanë një hapësirë banimi nën 5 m2për person.
- 33 përqind e këtyre familjeve jetojnë në shtëpi ku hapësira banuese për person është më shumë se 20 m2.

Figura 25 tregon numrin e individëve në një dhomë.

Figura 25: Numri i individëve në një dhomë



Burimi: INSTAT, 2008


Gjetjet:

- 71,8 përqind e familjeve shqiptare, jetojnë në dhoma me 1 deri në 2 njerëz të tjerë.
- 20,2 përqind e tyre jetojnë mbi 3 njerëz në një dhomë.

5.1.2 Problemet e strehimit

Figura 26 plotëson treguesin e mbipopullimit duke provuar të bëjë një vlerësim të cilësisë fizike të shtëpive të fëmijëve (INSTAT, 2008). Në mënyrë specifike ai tregon se sa përqind e familjeve me fëmijë në Shqipëri raportojnë më shumë se dy probleme në shtëpitë ku jetojnë. Llojet e problemeve janë: derë/dysheme/dritare e prishur, lagështirë në shtëpi, mungesa e tualetit brenda shtëpisë[15]

Figura 26: Përqindja e fëmijëve që raportojnë se kanë të paktën dy probleme fizike në shtëpitë e tyre.



Burimi: INSTAT, 2008

15 INSTAT(2008), Anketa e Buxhetit të Familjes

Gjetjet:

- Sipas Figurës së mësipërme, përqindja e fëmijëve të cilët raportojnë se kanë më shumë se një problem (të paktën 2) në shtëpitë e tyre, e tejkalon 15 përqind në të gjithë vendin.
- Përqindja më e madhe e fëmijëve që të cilët raportojnë probleme fizike të shtëpive të tyre është në zonën bregdetare (39,19 përqind), e ndjekur nga zona malore me 35,9 përqind dhe zona qendrore me 28,65 përqind.
- Zona e cila ka përqindjen më të ulët të fëmijëve që raportojnë probleme në shtëpitë e tyre është në kryeqytet, Tiranë (17,71 përqind). Kjo është e kuptueshme duke qenë se është zona më e zhvilluar në të gjithë vendin.

5.2 Siguria mjedisore

Komponenti i dytë i mirëqenies mjedisore të fëmijëve është siguria e mjedisit, siç matet nga dy tregues të ndryshëm: niveli i krimit dhe niveli i ndotjes

5.2.1 Krimi

Vuajtja e dhunës, të qenit dëshmitar i dhunës ose frika nga dhuna nuk duhet të jenë pjesë e rritjes. Megjithëse duket se ekspozimi i hershëm ndaj dhunës ndikon më rëndë te disa fëmijë se te disa të tjerë, rreziku për të gjithë fëmijët është se një mjedis dhune mund të ndërpresë zhvillimin nivelil dhe të ndikojë te mirëqenia afat-gjatë dhe afat-shkurtër. Pasojat mund të përfshijnë çrregullime në sjellje si, agresivitet dhe paaftësi për të hyrë në marrëdhënie me të tjerët, çrregullime emocionale, si depresion dhe ankth, si dhe çrregullime që lidhen me shëndetin, si çrregullim të gjumit dhe mankthe.

Matja dhe krahasimi i dhunës në mjedisin e fëmijës është dukshëm problematik. Shkallët e viktimizimit dhe të krimit do të ishin një matje e mundshme. Një udhëzues i përafërt në lidhje me nivelin e përgjithshëm të dhunës në shoqëri është shkalla e vrasjeve. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, shkalla e vrasjeve së qëllimshme (vrasje për 100 000 njerëz) është rritur në Shqipëri nga viti 2008. Në vitin 2008 kjo shkallë ishte *3 vrasje/100 000 njerëz*, por në vitin 2009 dhe 2010 ajo u rrit në *4 vrasje/100 000 njerëz*.

5.2.2 Ndotja

Komponenti i dytë i mirëqenies mjedisore të fëmijëve është shtrirja e ndotjes mjedisore. Është e vështirë për t'u matur dhe krahasuar. Në vendet e OECD-së ndotja mjedisore matet nga PM10 vjetore [µg/m3]. Në Shqipëri, sipas të dhënave të Bankës Botërore, ndotja e ajrit matet nga emetimet e CO2 në tonë metrikë për frymë. Sipas të dhënave të BB-së, ndotja e ajrit ka pasur një rënie të lehtë nga viti 2008 në vitin 2009. Në vitin 2008 ndotja e ajrit ishte *1,3 tonë metrikë/frymë* dhe në vitin 2009 ajo ishte *1 ton metrik/frymë*.

Pjesa 3

FËMIJËT PËR MIRËQENIEN E TYRE

Pavarësisht kufizimeve në të dhëna, vështrimi i mirëqenies së fëmijës i paraqitur më sipër përfaqëson pamjen aktuale statistikore të disponueshme të jetëve të fëmijëve në vend.


Por nuk është i vetmi vështrim i disponueshëm. Në vitet e fundit është bërë i mundur gjithashtu monitorimi i disa aspekteve të asaj se çfarë thonë vetë fëmijët për jetët e tyre. Prandaj kjo pjesë e këtij raporti trajton çështjen e mirëqenies nga pikëpamja subjektive e fëmijëve dhe disa nga argumentet rreth saj.

Mirëqenia nga pikëpamja subjektive konsiderohet me të drejtë si një matje më vete se sa si një komponent i një indeksi.

Kënaqësia nga jeta

Figura 27 ofron një vështrim të mirëqenies nga pikëpamja subjektive e fëmijëve në Shqipëri. Sipas studimit të Institutit të Shëndetit Publik "Vlerësimi i sjelljeve të shëndetshme te fëmijët e moshës shkollore", fëmijët u pyetën se "Sa të kënaqur ishin ata nga jeta e tyre"? . Për këtë matje ata përdorën një shkallë analoge pamore. "Shkalla" e sjelljeve të shëndetshme te fëmijët e moshës shkollore (HBSC) përbëhej nga 11 ndarje: më të kënaqurit renditeshin me pikët më të larta dhe më pak të kënaqurit renditeshin me pikët më të ulëta. Fëmijët u pyetën se në cilën shkallë do e vendosnin ata kënaqësinë për jetën e tyre (0 deri në 10 pikë).

Figura 27: Kënaqësia e fëmijëve nga jeta, 2013.




Burimi: Instituti i Shëndetit Publik, 2013

Gjetjet:

- Sipas Figurës së mësipërm mbi 33,6përqind e fëmijëve të moshës 11, 13 dhe 15 vjeç mendojnë se jeta e tyre është mjaftueshëm e mirë që të jetohet dhe 0,7përqind e këtyre fëmijëve mendojnë se jeta e tyre është jeta më e keqe që mund të kishin jetuar ndonjëherë.
- Sipas studimit, "kënaqësi e madhe nga jeta" konsiderohet kur fëmijët e raportojnë nivelin e kënaqësisë së tyre nga jeta mbi 6 pikë. 93përqind e fëmijëve raportojnë se kanë një "kënaqësi të madhe nga jeta" që do të thotë se 93përqind e tyre e kanë renditur nivelin e kënaqësisë nga jeta mbi 6 pikë.

Figura 28: Kënaqësia e fëmijëve nga jeta sipas grupmoshave, 2013.



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik, 2013

Gjetjet:

- Numri i fëmijëve 11 vjeçarë të cilët e rendisin jetën e tyre si jetën më të mirë (10 pikë), janë më të shumtë në numër se sa numri i fëmijëve 15 vjeçarë. 49,5përqind e fëmijëve 11 vjeçarë e rendisin jetën e tyre me 10 pikë dhe 19,7përqind e fëmijëve 15 vjeçarë e rendisin jetën e tyre me të njëjtat pikë.
- Përqindja e fëmijëve të cilët e rendisin kënaqësinë nga jeta e tyre me 0 pikë, janë më pak se 1përqind.

Marëdhëniet shoqërore


Cilësia e marrëdhënieve shoqërore, mund të jetë një vlerësues shumë i mirë i vlerësimit subjektiv të vetë fëmijëve dhe rrjedhimisht edhe një vlerësues i mirëqënies së tyre.

Që në vitet e hershme, perceptimi i mirëqenies së fëmijës nga pikëpamja subjektive është i lidhur ngushtë me marrëdhëniet dhe sidomos me prindërit dhe bashkëmoshatarët. Studimet kanë treguar se marrëdhëniet me bashkëmoshatarët mund të luajnë një rol të rëndësishëm si në mirëqenien e përditshme dhe në ecurinë zhvillimore afat-gjatë. Është nëpërmjet marrëdhënieve me bashkëmoshatarët që fëmijët eksperimentojnë me rolet në shoqëri dhe mësojnë e praktikojnë kontrollin e agresionit, menaxhimin e konfliktit, fitimin e respektit dhe të miqësisë, diskutimin e ndjenjave, vlerësimin e diversitetit dhe ndërgjegjësimin për nevojat dhe ndjenjat e të tjerëve.

Asnjë fëmijë nuk rritet pa përjetuar disa vështirësi dhe tension në marrëdhëniet me prindërit dhe bashkëmoshatarët, por për shumë fëmijë vështirësitë e tejzgjatura dhe më të rënda në këto marrëdhënie mund të shkaktojnë stres, ankth dhe depresion. Cilësia dhe kontributi i marrëdhënieve më të ngushta të fëmijës janë të vështira për t'u përcaktuar dhe matur. Çdo tregues i përdorur si vlerësues i marrëdhënieve shoqërore të fëmijëve, nuk mund të paraqesë më shumë sesa një vlerësim subjektiv të shifrave në nivel kombëtar. Megjithatë, mund të përfitohet një ide nga grafikët e mëposhtëm, që tregojnë lehtësinë e fëmijëve të moshës 11, 13 dhe 15 vjeç për të folur me prindërit e tyre dhe marrëdhënien e këtyre fëmijëve me miqtë e tyre.

Figura 29, 30 dhe 31 tregojnë lehtësinë e fëmijëve për të folur me prindërit e tyre.

Figura 29: Lehtësia e fëmijëve për të folur me prindërit e tyre, 2013




Burimi: Instituti i Shëndetit Publik, 2013

Gjetjet:

- Shumica e fëmijëve (63,3 përqind) e kanë më të lehtë të flasin me nënën e tyre për probleme të cilat ata i mendojnë si të rëndësishme, se sa me babain e tyre (37,3 përqind).
- Fëmijët e kanë afërsisht 3 herë më të vështirë të flasin me baballarët e tyre rreth problemeve (7,2 përqind) se sa me nënat e tyre (2,4 përqind).
- 3,5 përqind e fëmijëve nuk e kanë parë kurrë babain e tyre dhe 1,9 përqind e këtyre fëmijëve nuk e kanë parë kurrë nënën e tyre.

Figura 30: Lehtësia e fëmijëve për të folur me prindërit e tyre sipas grupmoshave, 2013




Burimi: Instituti i Shëndetit Publik, 2013

Gjetjet:

- 57,4 përqind e fëmijëve 11 vjeçarë e rendisin marrëdhënien me prindërit e tyre si të lehtë për të folur për problemet e tyre, ndryshe nga fëmijët 13 vjeçarë (46,8 përqind) dhe fëmijët 15 vjeçarë (38,4 përqind).
- 5,5përqind e fëmijëve 15 vjeçarë e kanë shumë të vështirë për të komunikuar me prindërit rreth problemeve të tyre.

Figura 31: Numri i miqve më të mirë, 2013



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik , 2013

Gjetjet:

- Mbi 18,8 përqind dhe 9,4 përqind e fëmijëve të moshës 11, 13 dhe 15 vjeçare, meshkuj e femra, raportojnë se nuk kanë asnjë mik të afërt
- 65,2 përqind dhe 56,6 përqind e këtyre fëmijëve raportojnë se kanë 3 ose më shumë miq të afërt meshkuj ose femra.

Matjet e mirëqenies së vetë raportuar janë subjekt i shumë debateve akademike. Shumë argumentojnë se nëse qëllimi është që të matet mirëqenia e fëmijëve, atëherë nuk ka metodë më direkte dhe të besueshme se sa të pyesësh vetë fëmijët të thonë se çfarë mendojnë për jetët e tyre. Matjet e vetë raportuara kanë avantazhin se i lejojnë vetë fëmijët të vendosin se cilat aspekte të jetëve të tyre janë të një rëndësie më të madhe.

Vështrimi i mirëqenies së fëmijës i paraqitur në pjesën 1 është një tregues i ndërtuar nga të rriturit, i kufizuar nga të dhënat e disponueshme. Nga ana tjetër vlerësimi subjektiv i kënaqësisë së fëmijëve tregon në një mënyrë më pak të strukturuar, por më domethënëse, se cilët janë ato elementë që sipas tyre janë edhe më të rëndësishmit për mirëqënien e tyre. Kjo përfshirje e fëmijëve bën që t›u respektohen të drejtat, t›u dëgjohet zëri dhe të përfshihen sa më shumë të jetë e mundur në procesin e matjes dhe promovimit të mirëqenies së tyre vetjake.

Disa gjykime subjektive të mirëqenies bëhen në lidhje me jetët e të tjerëve dhe kjo e vështirëson marrjen e një vështrimi të qartë. Kur u kërkohet të imagjinojnë "jetën më të mirë të mundshme për mua" dhe "jetën më të keqe të mundshme për mua", për shembull, disa fëmijë mund të marrin si kuadër reference jetët e familjes dhe të miqve, klasën dhe komunitetin, të tjerë mund të mendojnë më pak për botën rreth tyre dhe më shumë për botën virtuale siç portretizohet nga mediat e të gjitha llojeve. Ky mund të jetë një ndikim shtrembërues në nivelet e kënaqësisë nga jeta të vetë raportuar.

Për t'a përmbledhur, fëmijët ashtu si të rriturit, kanë të ngjarë ta përshtasin perceptimin e tyre për kënaqësinë nga jeta si mbështetur në realitetet e tyre vetjake dhe në shembujt dhe nivelit e vendosura nga shoqëritë në të cilat jetojnë. Ndonjëherë disa fëmijë të privuar dhe në disavantazh raportojnë se janë të kënaqur me jetët e tyre sepse në fakt nuk mund të presin asgjë më të mirë ose sepse janë mësuar të mos ankohen. Në të kundërt, disa fëmijë të privilegjuar raportojnë moskënaqësi sepse ata vazhdimisht ftohen të krahasojnë gjërat dhe mundësitë e tyre, pamjet dhe trupat dhe stilet e jetesës së tyre me të pasurit dhe të famshmit në komunitetin virtual mediatik të globalizuar dhe komercializuar.

Bibliografia

Brooks, Anne-Marie and Sinéad Hanafin, Report on the Development of a National Set of Child Well-Being Indicators in Ireland, 2005

Ceni. A, Profili i Varfërisë së Fëmijëve, UNICEF, 2011.

European Commission, "Communication from the Commission to the European Parliament and the Council - Enlargement Strategy and Main Challenges 2012-2013", Brussels,2012.

IKU & QKSS, Reformimi i ndihmës ekonomike: Nga mbijetesa tek investimi në reduktimin e varfërisë, UNICEF, 2011

INSTAT(2008), Anketa e Buxhetit të Familjes

Insituti i Shëndetit Publik, Vlerësimi i sjelljeve të shëndetshme te fëmijët e moshës shkollore, 2013.

Instituti i Statistikave, Instituti i Shëndetit Publik [Shqipëri] dhe ICF Macro. 2010, Studimi Demografik dhe Shëndetësor i Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri, 2008/2009.

Instituti i Statistikave, PNUD dhe Banka Botwrore (2009) Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, 2002-2005-2008

Kolpeja. V, Matja e Mirëqënies së Fëmijëve në Shqipëri, duke përdorur vrojtimet MICS dhe ADHS, UNICEF, 2011.

MPÇSSH, Strategjia e Përfshirjes Sociale, 2007/2013, (Draft)

NEF (2009), A guide to measuring children's well-being, Practical guide 2; (http://www.actionforchildren. org. uk/media/94477/action_for_children_a_guide_to_measuring_childrens_well_being. pdf)

OECD, PISA 2009, Results: Executive Summary, 2010

UNICEF, Innocenti Research Center, Child Poverty in Rich Countries 2005, Innocenti report Card No. 6, Florence, 2005

UNICEF, Innocenti Research Center, An overvieë of child well-being in rich countries, Innocenti report Card No. 7, Florence, 2007

UNICEF, Innocenti Research Center, Child well-being in rich countries; a comparative overvieë, Innocenti report Card 11, Florence, 2013, ISBN: 978-88-6522-016-0